

UNIVERSITETI PUBLIK I GJILANIT “KADRI ZEKA”

FAKULTETI: SHKENCA KOMPJUTERIKE

PROGRAMI I STUDIMEVE MASTER: E – QEVERISJE



PUNIM DIPLOME

**ETIKA E PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË DHE EFEKTI NË
MËSIMNXËNIE**

**(RAST STUDIMI DISA SHKOLLA TË MESME TË ULTA NË
KOMUNËN E GJILANIT)**

Mentorë:

Prof. Ass. Dr.Valbona ZEQRARJ

Kandidatja:

Kosovare BASHA

Gjilan,2025

UNIVERSITETI PUBLIK I GJILANIT “KADRI ZEKA”

FAKULTETI: SHKENCA KOMPJUTERIKE

PROGRAMI: E – QEVERISJE



PUNIM DIPLOME

Fakulteti: **Shkenca Kompjuterike**

Titulli punimit: ***“ Etika e përdorimit të teknologjisë dhe efekti në mësim nxënie ”***

Rast studimi Disa Shkolla të Mesme të Ultë në Komunën e Gjiatani

Emri dhe Mbiemri: **Kosovare BASHA**

Numri i amzës (ID Regjistrimi): **1218025**

Departamenti: **Fakulteti Shkencave Kompjuterike**

Niveli Studimeve: **Master**

Programi i studimit: **E-Qeverisja**

Mentor i punimit: **Prof.Ass. Dr.Valbona ZEQIRAJ**

Gjiatani, 2025



Universiteti Publik - "KADRI ZEKA" - Public University

rr. "Zija Shemsiu" pn.

60000 Gjilan tel:

+381280390112

e-mail: info@uni-gjilan.net

Programi i Studimeve Master

DEKLARATA ETIKE

Unë, **Kosovare Basha**, do të sigurohem që nxënësit të jenë të informuar plotësisht mbi natyrën, qëllimet dhe përdorimin e informacionit të mbledhur. Do të ruaj privatësinë si dhe anonimitetin e të dhënave të nxënësve, duke siguruar kështu që të dhënat e mbledhura të jenë të mbrojtura dhe të përdoren vetëm për qëllimin e hulumtimit. Do të sigurohem që të gjitha burimet dhe referencat që do të përdoren në punën time të jenë të renditura dhe të citohen siç duhet.

Në Gjilan //2025

Kosovare Basha

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Me rastin e përfundimit të nivelit të studimeve Masterit, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij projekti.

Fillimisht, një falënderim shumë i veçantë shkon për familjen time dhe bashkëshortin, të cilët më kanë mbështetur dhe inkurajuar gjatë gjithë procesit të studimeve. Dashuria dhe përkrahja e tyre janë pasuria ime më e madhe dhe ndihma e tyre ka qenë e paçmuar në këtë udhëtim akademik.

Përkushtimi dhe udhëheqja e mendores time Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj kanë qenë pika kyçe për suksesin e këtij projekti. Të falënderoj për këshillat e vyera, përkushtimin si dhe ndihmën në çdo moment që keni ofruar gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe përgatitjes së këtij punimi.

Faleminderit të gjithëve!

ABSTRAKT

Etika përfshin të gjitha parimet dhe standardet e praktikës në arsim, që synon edukimin dhe karakterin e nxënësve ku nëpërmjet përpjekjeve të ndryshme sjellë virtyte kryesore që janë të mira për individin dhe për shoqërinë. Teknologjia në arsim ka sjellë shumë ndryshime thelbësore, duke avancuar mësimin në mënyrë të pazëvendësueshme. Përdorimi i pajisjeve dhe aplikacioneve inteligjente ka hapur shumë rrugë për një eksperiencë mësimore të personalizuar, duke lejuar nxënësit të zhvillojnë shkathtësitë e tyre në mënyrë më efektive.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të kuptohet se si përdorimi i teknologjisë në mësim ndikon në perspektiven dhe përvojën e nxënësve si dhe për të vlerësuar nëse përdorimi i teknologjisë reflekton në standardet etike dhe atë edukative duke u bazuar në perceptimet dhe përvojat e nxënësve. Metodat të cilat i kemi përdorur gjatë hulumtimit janë : metoda përshkruese përmes së cilës janë bërë hulumtime nga literaturat të cilat janë marrë nga autorë të ndryshëm si dhe punime shkencore të lidhur me temën *Etika e Përdorimit të Teknologjisë dhe efekti në mësim nxënie*, si dhe burime nga interneti.

Gjithashtu gjatë punimit kemi përdorur metodën sasiore ku do të ndërtojmë pyetësorët duke përdorur një kombinim të pyetjeve të hapura dhe të mbyllura duke marr vlerësimet dhe sugjerimet e nxënësve në 3 Shkolla Filllore të Gjilanit ku si mostër(të mbledhjes së të dhënave), kemi marrë klasat 6-9, kjo më ka ndihmuar që më lehtë të bëjë krahasimin e variablave të ndryshme të përdorura për të testuar hipotezat e parashtruara. Në përfundim qëllimi është të sjellë integrimin e etikës në arsim, kontribute në përmirësimin e përdorimit të teknologjisë në mësim dhe për të ofruar rekomandime konkrete për praktika mësimore në disa Shkolla Filllore të Gjilanit.

Fjalët kyqe: *Etik, Teknologji në mësim, nxënës, ,mësim nxënie, ndikimi teknologjis*

ABSTRACT

Ethics includes all the principles and standards of practice in education, aimed at the education and character of students, where through different efforts it brings the main virtues that are good for the individual and for society. Technology in education has brought many fundamental changes, advancing learning irreplaceably. The use of smart devices and applications has opened many avenues for a personalized learning experience, allowing students to develop their skills more effectively.

The main purpose of this research is to understand how the use of technology in learning affects the perspective and experience of students as well as to assess whether the use of technology reflects ethical and educational standards based on the perceptions and experiences of students.

The methods that we used during the research are: the descriptive method through which research was done from the literature that was taken from different authors as well as scientific works related to the topic of the Ethics of Technology Use and its effect on learning, as well as sources from the internet.

Also during the work we used the quantitative method where we will build the questionnaires using a combination of open and closed questions taking the evaluations and suggestions of the students in 3 Primary Schools of Gjilan where as a sample (of data collection), we took the classes 6-9, this has helped me to more easily compare the different variables used to test the hypotheses presented. In conclusion, the aim is to bring the integration of ethics in education, contributions to the improvement of the use of technology in teaching and to offer concrete recommendations for teaching practices in some Primary Schools of Gjilan.

Keywords: *Ethics, Technology in learning, students, learning, impact of technology*

Përmbajtja

ABSTRAKT	5
Lista e Figurave	9
Tabela e Grafikëve	9
Lista Tabelave.....	10
Shkurtesat	10
KAPITULLI I.....	11
1. HYRJA	11
1.1 Përkufizimi i problemit që hulumtohet	12
1.2 Qëllimi i studimit dhe objektivat	13
1.3 Gjendja aktuale e studimeve për problemin e hulumtuar (baza teorike).....	14
1.4 Hipotezat, pyetjet kërkimore dhe formulimi i problemit të hulumtimit.....	15
Pyetjet kërkimore	15
1.5 Metodologjia dhe metodat e hulumtimit	16
1.6 Rezultatet e pritura	17
KAPITULLI II	18
2. RISHIKIMI I LITERATURËS.....	18
2.1 Evoluimi i efekteve të teknologjisë në performancën akademike.....	18
2.1.1 Teknologjia në mësimnxënie	20
2.1.2 Përkufizimi i etikës në teknologji	21
3. Roli i nxënësve në përdorimin etik të teknologjisë	22
3.1 Standarde dhe rregulla etike për përdorimin e teknologjisë në edukim	23
3.2 Ndikimi i etikës në zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies	24
4. Privatësia dhe siguria e të dhënave në edukim.....	25
4.1 Rreziqet dhe sfidat në ruajtjen e privatësisë gjatë përdorimit të teknologjisë	26
4.2 Avantazhet e teknologjisë në mësimnxënie	27

5. Sfidat etike në teknologji	28
5.1 Problematikat e përdorimit të teknologjisë për qëllime të gabueshme.....	29
KAPITULLI III.....	30
6. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	30
6.1 Metodat e hulumtimit.....	30
6.2 Instrumentet e hulumtimit.....	31
6.3 Populacioni dhe mostra.....	32
6.4 Procedura e mbledhjes dhe analizës së të dhënave	33
KAPITULLI IV	34
7. PREZENTIMI, ANALIZIMI DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE	34
7.1 Prezantimi dhe analizimi i rezultateve	34
7.2 Argumentimi i pyetjeve kërkimore	46
7.3 Testimi i hipotezave.....	49
KAPITULLI V	54
8.PERFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	54
8.1 Përfundimi	54
8.2 Rekomandime	56
SHTOJCAT	65

Lista e Figurave

Figura 1. Evoluimi i efekteve të teknologjisë në performancën akademike.....	19
Figura 2. Rreziqet dhe sfidat në ruajtjen e privatësisë gjatë përdorimit të teknologjisë.....	27

Lista e Grafikonëve

Grafiku 1. Gjinia	34
Grafiku 2. Mosha	35
Grafiku 3. Emri Shkollës	36
Grafiku 4. A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja.....	37
Grafiku 5. A mendoni që përdorimi i teknologjisë ka ndryshuar mënyrën si mësoni, veçanërisht në krahasim me mënyrën tradicionale të mësimi?	38
Grafiku 6. A keni vërejtur ndonjë ndryshim në motivin tuaj për të mësuar kur teknologjia përdoret në mësim.....	39
Grafiku 7. A mendoni se teknologjia mundë të ndihmojë për të përmirësuar cilësinë e mësimi dhe për të arritur qëllimet e arsimit?	40
8. Çfarë përparësish mendoni se vijnë nga përdorimi i teknologjisë në mësim në krahasim me metodat tradicionale?	41
9. A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe sigurinë në internet?	42
10. A keni ndonjë shqetësim për çështjet etike në lidhje me përdorimin e teknologjisë në mësim? Nëse po cilat janë ato dhe si mendoni se mundë të adresohen?	43
Grafiku 11. A mendoni se është e rëndësishme që teknologjia të përdoret në mënyrë etike në mësim?	44
12. Çfarë do të dëshironit të ndryshonte në përdorimin e teknologjisë në shkollën tuaj?	45

Lista Tabelave

Tabela 1.Të Dhënat e Hipotezës H1	49
Tabela 2.Të Dhënat e Hipotezës Ndihmëse	50

Shkurtesat

TIK- Teknologji Informative Komunikimi

PC- Personal Computer

TA- Teknologjia Arsimore

ETK- Etikë

M&M- Mësimdhënia dhe Mësim nxënia

PS- Privatësia dhe Siguria

NX- Nxënësit

KAPITULLI I

1. HYRJA

Etika përfshin sigurinë fizike, emocionale të nxënësve duke garantuar një mjedis mësimor të sigurt dhe mbështetës për të gjithë (MWL, 2017). Trajtimi i barabartë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit, pa përjashtime dhe pa përparësi të padrejta si dhe reflektimin mbi përdorimin e teknologjisë në mësim, garantimin që ky përdorim të jetë i përputhur me parimet dhe vlerat etike të arsimit. Interneti ofron një mënyrë shumë më të përshtatshme dhe inovative të të mësuarit. Teknologjitë e reja në mësimdhënie paraqesin avantazhe dhe benifite. Një ndër këto është një e mirë nga fakti që nxënësit kur janë duke punuar në kompjuter, mund të ndihen lirshëm të bëjnë një detyrë ku edhe mund të dështojnë në fillim por mund të rifillojnë përsëri pa frikën e gjykit se mund të nënçmohet, pra gjithçka është e lirë për ta (HAJDARI P. A., 2019).

Kompjuterët dhe eksesi në internet përmirësojnë cilësinë e edukimit. Kjo lidhet me faktin që interneti tashmë shihet si një mjet i rëndësishëm për të gjetur burime të reja që ndihmojnë në arritjen e standardeve të reja. Zhvillimi i shoqërisë teknologjike paraqet një nga detyrat prioritete të gjitha qeverive botërore. Arsimi është një nga segmentet më kryesore në nxitjen dhe përkrahjen e zhvillimit të shoqërisë teknologjike, të jetë promotor i shoqërisë teknologjike si dhe të përkrah krijimin e kuadrove profesionale dhe kompetente të cilët mund t'ju përgjigjen sfidave të shoqërisë teknologjike dhe nevojave të ndryshme të bazuar në dituri , etikë si dhe cilësinë e procesit edukativo arsimor në mënyrë të drejtë (DEMELEZI, 2017).

Nga gjithë ajo që u tha më lartë gjatë këtij punimi vijmë në përfundim se përdorimi i teknologjisë në mësim është forma më efektive për nxënësit me qenë më të suksesshëm. Objektivi i këtij punimi është që hulumtimi synon të identifikoj përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë nga perspektiva e nxënësve ku dhe një rolë kryesorë ka edhe etika.

1.1 Përkufizimi i problemit që hulumtohet

Ajo se çka më ka shtyrë deri te përzgjedhja e kësaj teme ka ardhur si rezultat i përvojës time në fushën e teknologjisë në mësim në Shkolla Fillore, më ka shtyrë që ti qasem kësaj teme më shumë, dhe si rrjedhojë e gjithë kësaj mendoj se rezultatet e gjetjeve të punimit nuk do të mungojnë, sigurisht do jetë dhe temë e rëndësisë së veçantë që do të kontribuoj për shkolla të ndryshme duke pasur parasysh faktorët dhe problemet që do trajtojmë në temën në fjalë.

Është një studim i përqendruar në kuptimin e ndikimit të përdorimit të teknologjisë në mësim mbi perspektivën, angazhimin, performancën e nxënësve si dhe të vlerësojë përputhshmërinë e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor me standardet etike të edukatës në disa Shkolla Fillore të Gjilanit. Ky hulumtim synon të analizojë se si nxënësit e përdorin teknologjinë në procesin mësimor dhe në mënyrën e të mësuarit, perceptimet e tyre në lidhje me etikën e përdorimit të teknologjisë në mësim.

Arsyetimi i Temës, teknologjia është një pjesë e pandashme e jetës së përditshme dhe e shoqërisë moderne. Duke e shqyrtuar përdorimin e saj në kontekstin shkollor, hulumtimi ka rëndësi për të kuptuar se si kjo influencon përvojën e nxënësve. Ky studim synon të identifikojë këto ndryshime dhe t'i kuptojë pasojat e tyre. duke përfshirë analizën e përvojave dhe perceptimeve të nxënësve, hulumtimi synon të vijë me rekomandime konkrete etikën në përmirësimin e përdorimit të teknologjisë në mësim dhe të ndihmojë në zhvillimin e praktikave arsimore.

1.2 Qëllimi i studimit dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të kuptohet një vlerësim statistikorë i gjendjes aktuale të digjitalizimit, të shqyrtojë dhe të vlerësojë përputhshmërinë e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor në disa Shkolla Fillore të Gjilanit me standardet etike të edukatës. Kjo përfshinë vlerësimin e mënyrave se si nxënësit ndihen, angazhohen, mësojnë duke përdorur pajisje dhe aplikacione teknologjike në procesin mësimor. Hulumtimi synon të identifikoj përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë nga perspektiva e nxënësve. Duke shqyrtuar ndikimin e saj në motivim, angazhim si dhe përgatitjet për të ardhmen.

Në këtë punim do të paraqesim kërkimet dhe rezultatet e dalura nga njohuritë *Etika e Përdorimit të Teknologjisë dhe efekti në mësimnxënje* në disa Shkolla Fillore, njohjen e strategjive të përdorimit të teknologjisë në mësim, formulimin e tyre përmes pyetësorëve të tregohet në praktikë çfarë strategjie përdorin shkollat etj. Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të studimit kam përpiluar objektivat përmes së cilave synoj të përmbush qëllimin e këtij studimi, e ato janë:

Objektiva e përgjithshme:

Etika e përdorimit të teknologjisë me qëllim që të ndikoj dhe reflektoj në standardet etike dhe atë edukative duke u bazuar në perceptimet dhe përvojat e nxënësve.

Objektiva specifike:

- a) Perceptimet e nxënësve lidhur me përdorimin e teknologjisë në mësim;
- b) Ndikimi i etikës gjatë përdorimit të teknologjisë;
- c) Ndikimi i teknologjisë në cilësinë e mësimin.

1.3 Gjendja aktuale e studimeve për problemin e hulumtuar (baza teorike)

Parimet etike nuk mund të përdoren më si rregulla teorike, trashëgimi sociale por si instrumente të cilat zhvillohen nga nevoja për të zgjidhur problemet, dhe për të siguruar përfitime për një individ, institucion, dhe për shoqërinë në përgjithësi (aty), 2017).

Formimi i karakterit moral të fëmijëve duhet të jetë qëllimi kryesor i edukimit. Në këtë drejtim të gjitha shkollat duhet të kenë qëndrimin etik të tyre i cili do të udhëheqë arsimin drejt formimit moral të fëmijëve, parimet e të mirës, lirisë, lumturisë, dhe aftësisë për t'i përshtatur me këto parime me situata dhe probleme specifike (HELD, 2006).

Pc shihet si një nga teknologjitë më kyqe në fushën e mësimdhënies, vite më parë konsiderohej si një risi, tashmë ai është shumë i domosdoshëm për shkak të avancimeve teknologjike që kanë përfshirë mësimdhënien (Ejupi, 2021). Zhvillimet e hovshme teknologjike po ndikojnë edhe tek mënyra e të mësuarit. Tani klasat e transformuara u japin mundësi të ndryshme fëmijëve të mësojnë nga robotët si dhe të ndërtojnë robotët e tyre (HAJDARI B. , 2019). Këto sisteme po ofrojnë studentëve mundësi të mësojnë në një formë më logjike dhe jo përmendësh (Sivasubramanian, 2021).

TIK-u e ka lehtësuar shumë përditshmërinë në fushën e arsimit, në mësimin dhe përvetësimin e gjuhëve të huaja. Përdorimi multimedial, aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përvetësimin e gjuhëve të ndryshme ka ndryshuar dinamikën e jetës në ditët e sotme, sidomos atë në fushën e arsimit (Shehu, 2020).

Duke i përdorur teknologjitë në qasjen konstruktivi të mësuesit e kanë më të lehtë të përfshijnë nxënësit në aktivitetet mësimore. Ata mund të krijojnë aktivitete për nivele të ndryshme të të nxënësve si dhe mund të zgjerojnë gamën e marrjes së informacioneve që janë në dispozicion të nxënësit (Zatriqi, 2022). Përparimet në teknologji tashmë kanë një rol kyq në përgatitjen e nxënësve për të përdorur atë, që ata mësojnë në çdo lëndë për të gjetur vendin e tyre në fuqinë punëtore botërore. Nisur nga hulumtimet e bëra në internet, përdorimi i përditshëm i *teknologjisë në mësim*, lirisht mund të themi se në të ardhmen teknologjia do të luaj një rol të rëndësishëm në mësimin e nxënësve.

1.4 Hipotezat, pyetjet kërkimore dhe formulimi i problemit të hulumtimit

Hipoteza

Për një studim sa më të mirëfilltë të Përdorimi i Teknologjisë në Mësim dhe Perspektiva e Nxënësve do të paraqesim hipotezat kryesore dhe ndihmëse:

- H1: Integrimi i teknologjisë forcon cilësinë dhe efektivitetin e mësimi.
- Hipoteza ndihmëse: Perspektiva e nxënësve në lidhje me përdorimin e teknologjisë forcon cilësinë në mësim si dhe reflekton në ndërgjegjen etike.

Pyetjet kërkimore

1. A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja?
2. A e perceptojnë teknologjinë si një mjet për të përmirësuar cilësinë e mësimi?
3. A ndikon përdorimi i teknologjisë në mësim në aspektin e cilësisë së informacionit dhe burimeve të disponueshme për nxënësit?
4. A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe sigurinë në internet?
5. A mund të ketë teknologjia ndikime negative në aftësinë e nxënësve për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme dhe respektuese në ambientin mësimor?

1.5 Metodologjia dhe metodat e hulumtimit

Metodologjinë që kemi përdorur gjatë hulumtimit është : metoda përshkruese përmes së cilës janë bërë hulumtime nga literaturat të cilat janë marrë nga autorë të ndryshëm si dhe punime shkencore të lidhur me temën *Etika e Përdorimit të Teknologjisë dhe efekti në mësimnxënje*, si dhe burime nga interneti. Gjithashtu gjatë punimit kemi përdorur metodën sasiore ku kemi ndërtuar pyetësorët duke përdorur një kombinim të pyetjeve të hapura dhe të mbyllura.

Duke marrë vlerësimet dhe sugjerimet e nxënësve në 3 Shkolla Fillore të Gjilanit ku si mostër(të mbledhjes së të dhënave) kemi marrë klasat 6-9, kjo do të më ndihmojë që më lehtë të bëjë krahasimin e variablave të ndryshme të përdorura për të testuar hipotezat e parashtruara.

Gjatë procesit të anketimit është shpjeguar shumë qartë që nxënësit ta kuptojnë pyetjet e studimit, mënyrën e plotësimit të pyetësorit dhe kemi kërkuar prej tyre që ti plotësojnë me sinqeritet pyetësorët, pasi që i njëjti përdoret për qëllime studimore. Pas përfundimit të studimit do të përqendrohemi në analizën e pyetësorëve, nga të cilat do të nxirren edhe rezultatet të pasqyruara në formë grafike si dhe komentimi secilës nga këto me shpjegime adekuate.

1.6 Rezultatet e pritura

Vlerësimi të mendimeve, ideve, kontributeve të tjerëve është një çështje e rëndësishme etike si dhe akademike që do t'i kushtojmë rëndësi në punimin tonë. Në këtë punim do të përdorim drejt referencat dhe do të vlerësojmë punën e të tjerëve. Në këtë punim hulumtues fokusin kryesor do ta vëmë te etika e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe si ndikon në perspektivën dhe përvojën e nxënësve.

Si dhe rezultatet e gjetura do t'i paraqesim në formë tabelore dhe me anë të grafikëve. Ideja e punimit është realizimi i një hulumtimi për të identifikuar dhe analizuar gjendjen e Etikës në Përdorimin e Teknologjisë në Mësim dhe Perspektiva e Nxënësve.

Andaj, punimi është i ndarë në disa kapituj ku përfshihen:

- » *Shqyrtim literature; ku bëhet shpjegimi i detajuar i të dy nocioneve dhe veçorive të tyre;*
- » *Deklarimi i problemit; ku shqyrtohet arsyeja pse pikërisht kjo temë është zgjedhur për studim;*
- » *Metodologjia, ku shpjegohet mostra e hulumtuar dhe pyetësorët e përdorur në procesin e kërkimit;*
- » *Rezultatet; ku përshkruhen në mënyrë të detajuar rezultatet e nxjerra nga mostra e hulumtuar;*
- » *Diskutime dhe konkluzione; ku janë të paraqitura përfundimet nga hulumtimi;*
- » *Rekomandimet; Rekomandimet; ku paraqiten sugjerime për përmirësimin e përdorimit të teknologjisë në mësim dhe perspektivat e nxënës.*

KAPITULLI II

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Evoluimi i efekteve të teknologjisë në performancën akademike

Ndikimi i teknologjisë në performancën akademike varet nga disa faktorë, përfshirë cilësinë e softuerëve edukativë, nivelin e integritit të teknologjisë në praktikat e mësimdhënies, dhe mbështetje që u ofrohet mësuesve dhe studentëve për përdorimin efektiv të këtyre mjeteve (Squire, 2011). Për të vlerësuar në mënyrë të saktë ndikimin e teknologjisë në performancën akademike, është thelbësore të konsiderohet jo vetëm prania e teknologjisë, por gjithashtu mënyra e përdorimit të saj, konteksti në të cilin aplikohet dhe qëllimet që synon të arrijë (Dawson, 2013).



Burimi: Marr nga interneti

Teknologjia e informimit dhe komunikimit përfshin të gjitha teknologjitë që përdoren për krijimin, përpunimin, ruajtjen, këmbimin dhe përdorimin e informacionit në të gjitha format e tij (Berisha, 2018). Teknologjia përfshin përdorimin e njohurive të shumta për të krijuar rezultate dhe për të përmirësuar të kuptuarit. Mjetet digjitale mund të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të integrohen më mirë me botën përreth tyre. Kjo ka një ndikim të madh në arsim edhe pse këto përshkrime ndonjëherë mund të duken të ndryshme, të dyja e theksojnë rëndësinë e teknologjisë si një burim që ndihmon nxënësit të kenë akses në informacion, të krijojnë dhe ta modifikojnë atë për të

avancuar procesin e të mësuarit dhe të kuptuarit (Brodowicz, 2024).

Integrimi i teknologjisë informative dhe të komunikimit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies nënkupton përdorimin efikas të kompjuterëve dhe softuerëve, shfrytëzimin e internetit dhe aplikimin e rrjeteve kompjuterike për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe të nxënies (Mexhuani, 2014). Sot, teknologjia arsimore përdoret për të rritur efektivitetin e studimit dhe mësimdhënies duke optimizuar procese, strategji dhe menaxhimin e kohës, si dhe duke reduktuar kostot dhe barrierat gjeografike .

Shtrirja e teknologjisë arsimore mund të ndahet në tre kategori kryesore:

- ☐ **Teknologjia Arsimore dhe Testimi Arsimor:** Përfshin provimet online, vlerësimet, dhe vlerësimet nga kolegët, etj.
- ☐ **Teknologjia Arsimore dhe Procedurat Akademike:** Këtu përfshihen zhvillimi i përmbajtjes, trajnimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve, dhe krijimi i strategjive për mësimdhënie dhe nxënie, etj.
- ☐ **Procedurat e Teknologjisë Arsimore dhe Administrimi Arsimor:** Përfshin aplikimin e teknologjisë për administrimin e arsimit në përgjithësi (Haxhijaj, 2023).

Qëllimi i arsimit është të ofrojë studentëve njohuri që ata mund t'i aplikojnë në jetën e përditshme dhe në karrierën e tyre të ardhshme. Mësimdhënia duhet të përditësohet në përputhje me trendët moderne, në mënyrë që institucionet arsimore të mund të ofrojnë studentëve njohuri të përdorshme dhe të përditësuara (Robinson, 2015).

2.1.1 Teknologjia në mësimnxënie

Sot, teknologjia nuk është më një mjet anësor, por një element esencial që mundëson përmbushjen e nevojave edukative dhe përmirëson cilësinë e të nxënës dhe praktikave edukative dhe përmirëson cilësinë e të nxënës dhe praktikave edukative (Bates, 2015).

Studimet e shumta mbi teknologjinë edukative tregojnë se përdorimi i saj në mënyrë strategjike mund të ndihmojë në përmirësimin e ndjeshëm të rezultateve të të nxënës. Kur integrimi i teknologjisë në mësimdhënie bëhet në mënyrë të duhur, ajo ofron mundësi të reja për angazhimin e studentëve dhe për përmirësimin e procesit edukativ.

Megjithatë, është e rëndësishme që teknologjia të përdoret si një mjet mbështetës dhe jo si një zëvendësues i metodave tradicionale të mësimdhënies (Clark, 1994).

Mësimi i kombinuar ka fuqinë të transformojë mënyrën se si ndodhin proceset edukative duke kombinuar elemente të mëimit online me metodat tradicionale. TA ofron fleksibilitet të lartë dhe mundësi për personelin e përvojës mësimore, duke rritur angazhimin dhe performancën e studentëve. Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie përfaqëson një avancim të rëndësishëm për të ndihmuar studentët të arrijnë sukses më të madh në një ambient edukativ gjithnjë e më të ndryshueshëm (Aragon, 2010) .

Teknologjia ka transformuar arsimin duke ofruar metoda më të avancuara dhe më efikase për të mbështetur mësimdhënien dhe nxënien.

Integrimi i teknologjisë në arsim ka mundësuar krijimin e ambientesh më interaktive dhe të personalizuar për studentët, duke bërë që procesi mësimor të jetë më angazhues dhe më i suksesshëm (Thomas, 2003). Teknologjia e distancës ka revolucionarizuar ofrimin e edukimit, duke mundësuar që studentët nga çdo lokalitet të kenë qasje në materialet edukative dhe të angazhohen në mësim në mënyra që nuk ishin të mundshme më parë (Moore, 2013).

2.1.2 Përkufizimi i etikës në teknologji

Etika në teknologji shqyrton implikimet morale të zhvillimeve dhe inovacioneve teknologjike, si dhe ndikimin e tyre në vlerat dhe praktikën shoqërore. Kjo fushë thekson përgjegjësinë e zhvilluesve të teknologjisë për të analizuar dhe marrë në konsideratë pasojat e krijimeve të tyre mbi të drejtat e individëve dhe normat e shoqërisë.

Ajo synon të sigurojë që teknologjitë të zhvillohen dhe përdoren në përputhje me parimet etike dhe standardet e drejtësisë, duke kontribuar në mirëqenien e përgjithshme shoqërore (Tavani, 2011). ETK e shpikjes shqyrton jo vetëm mundësitë që teknologjia ofron, por edhe detyrimet dhe përgjegjësitë që ajo ka.

Kjo fushë kërkon një angazhim të thellë dhe reflektues për të vlerësuar ndikimet e mundshme të avancimeve teknologjike në mirëqenien njerëzore dhe në normat etike, duke synuar të sigurojë që shpikjet dhe zhvillimet teknologjike të kontribuojnë në mënyrë pozitive dhe të përputhen me vlerat e drejtësisë dhe etikës (Jasanoff, 2016).

Etika në teknologji merret me aspekte morale që lidhen me zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë. Ajo ka për qëllim të sigurojë që përparimet teknologjike të përputhen me parimet etike, duke promovuar drejtësinë, llogaridhënien dhe respektin për dinjitetin njerëzor. Kjo fushë shqyrton si ndikimet e teknologjisë ndihmojnë në ruajtjen e vlerave dhe standardeve të shoqërisë, duke u përpjekur të balancojë inovacionin me përgjegjshmërinë sociale dhe etike (Kieffer, 2019).

Etika e informacionit dhe kompjuterëve është një degë e etikës së aplikuar që shqyrton çështjet etike të lidhura me zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Kjo fushë analizon ndikimet e këtyre teknologjive në të drejtat e njeriut, privatësinë dhe vlerat shoqërore, duke kërkuar mënyra për të balancuar përfitimet e teknologjisë me respektin për standardet etike dhe kërkesat e shoqërisë (Floridi, 2010).

3. Roli i nxënësve në përdorimin etik të teknologjisë

Nxënësit luajnë një rol kyç në përdorimin etik të teknologjisë, duke qenë të angazhuar për të kuptuar dhe respektuar të drejtat e autorit dhe normat e privatësisë. Edukimi i tyre në lidhje me përdorimin e drejtë të informacionit dhe teknologjisë është esencial për ndërtimin e një shoqërie të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme në aspektin teknologjik. Kjo nënkupton që ata duhet të zhvillojnë një kuptim të thellë të përgjegjësisë të tyre dhe të kontribuojnë në përdorimin e teknologjisë në mënyrë që mbështet dhe respekton standardet etike dhe ligjore (Council, 2000). Nxënësit kanë një rol kyç në përdorimin etik të teknologjisë, duke mësuar dhe aplikuar parimet etike që lidhen me përdorimin e saj.

Është thelbësore që ata të jenë të vetëdijshëm për pasojat që ndodhin nga përdorimi i teknologjisë dhe të zhvillojnë një ndjenjë të fortë të përgjegjësisë dhe respektit ndaj të tjerëve në hapësirën dixhitale. Kjo përfshin jo vetëm njohjen e rregullave dhe standardeve etike, por edhe angazhimin për të promovuar një përdorim të përgjegjshëm dhe të ndershëm të teknologjisë (Quinn, 2011). Në epokën dixhitale, nxënësit janë përdorues aktivë të teknologjisë dhe, si të tillë, kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e etikës online. Edukimi në etikën e teknologjisë ndihmon nxënësit të kuptojnë në mënyrë të thellë pasojat e veprimeve të tyre në hapësirën virtuale dhe të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të ndershëm në internet. Ky proces edukativ i nxit ata të ushtrojnë një përdorim të përgjegjshëm të teknologjisë, duke respektuar normat dhe vlerat etike në komunikimin dhe ndërveprimin e tyre online (Spinello, 2003).

Për nxënësit, përdorimi etik i teknologjisë është një sfidë që i përfshin të gjithë të kuptuarit e normave kulturore dhe ligjore që rregullojnë hapësirën dixhitale. Njohuria dhe respekti për këto norma janë shumë të nevojshme për të garantuar që teknologjia të përdoret në mënyrë të përgjegjshme dhe të respektueshme (Sanden, 2006). Roli i nxënësve në përdorimin etik të teknologjisë përfshin më shumë se thjesht ndjekjen e të gjitha rregullave; përfshin zhvillimin në kuptimin e thellë të etikes dhe ligjeve që rregullojnë përdorimin e teknologjisë në shoqëri. Kjo kërkon edukim dhe ndërgjegjësim të vazhdueshëm për të siguruar që përdorimi i teknologjisë të kontribuojë në përmirësimin e jetës dhe të mbrojë të drejtat e individëve (Duranti, 2008).

3.1 Standarde dhe rregulla etike për përdorimin e teknologjisë në edukim

Teknologjia në edukim kërkon një balancim të kujdesshëm ndërmjet avantazheve si dhe rreziqeve të saj. Për tu siguruar që përdorimi i teknologjisë të jetë i drejtë dhe etik, është thelbësore të zhvillohen dhe të ndiqen standarde të qarta që mbrojnë privatësinë e studentëve, ruajnë integritetin e informacionit dhe promovojnë një ambient edukativ përfshirës.

Këto standarde duhet të jenë të detajuara dhe të specifikuara, duke adresuar ndjeshmërinë e të dhënave dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë (Hall, 2021).

Profesorët duhet që të jenë të informuar dhe të trajnuar për të i kuptuar dhe zbatuar këto standarde si dhe duke u siguruar që teknologjia të përdoret në mënyrë të drejtë që të përmirësojë mësimdhënien dhe të mos krijojë rreziqe për studentët (Watson, 2024).

Është thelbësore që edukatorët të jenë të vetëdijshëm për implikimet etike të zgjedhjeve të tyre teknologjike. Mjetet teknologjike duhet të ndihmojnë në procesin e mësimin, duke respektuar gjithashtu privatësinë dhe dinjitetin e studentëve.

Përdorimi i teknologjisë duhet të jetë i menduar, i fokusuar në nevojat e studentëve, dhe të krijojë një ambient të sigurt dhe mbështetës për të gjithë ata që janë të angazhuar në mësimdhënie. Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e një kulture edukative që vlerëson etikën dhe përgjegjshmërinë (McGreal, 2017).

Ndërsa institucionet arsimore po e përdorin gjithnjë e më shumë teknologjinë dixhitale, mbrojtja e të dhënave të studentëve dhe siguri i transparencës mbi përdorimin e tyre janë përgjegjësi etike shumë të rëndësishme. Edukatorët dhe administratorët duhet të kuptojnë se çdo informacion i mbledhur mund të ketë një ndikim të thellë në jetën e studentëve, prandaj duhet të trajtohet me kujdes dhe përgjegjshmëri. Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e besimit dhe në krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin arsimor (Selwyn, 2019).

3.2 Ndikimi i etikës në zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Etika ka një rol thelbësor në zhvillimin e praktikave të mësimdhënies dhe mësim nxënies, duke ndikuar në mënyrën si profesorët ndër veprojnë me studentët dhe si ata ndjekin politika të drejta dhe të përgjegjshme në mjedisin edukativ. Është thelbësore që mësuesit të mbajnë standarde të larta etike, pasi kjo ndihmon në ruajtjen e integritetit akademik. Të sigurohet një mjedis i ndershëm dhe i barabartë për të gjithë studentët është çelësi për të krijuar një atmosferë të përshtatshme për mësim. Praktikrat e ndershme M&M jo vetëm që promovojnë drejtësinë, por gjithashtu inkurajojnë besimin mes studentëve dhe mësuesve, duke forcuar kështu lidhjet dhe përkushtimin për arsimimin cilësor.

Një ambient i tillë kontribuon në zhvillimin e individëve të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm, të cilët janë të gatshëm të përballen me sfidat e jetës.

Këto standarde përfshijnë mbrojtjen e privatësisë së studentëve si dhe transparencën në vlerësim dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë nxënësit (Green P. M., 2022).

Kjo nënkupton ndjekjen e rregullave etike që ndihmojnë në parandalimin e përvetësimit të ideve, manipulimin e rezultateve dhe përdorimin e procedurave të paqarta në vlerësim. Një mjedis mësimor etik promovon një kulturë ndihme dhe respekti, që është thelbësore për suksesin akademik dhe zhvillimin personal të studentëve (White, 2023).

4. Privatësia dhe siguria e të dhënave në edukim

Institucionet edukative po mbledhin dhe analizojnë gjithnjë e më shumë të dhëna në lidhje me studentët, çka krijon shqetësime të rëndësishme për privatësinë dhe sigurinë e këtyre të dhënave. Këto shqetësime kërkojnë që të zbatohen politika dhe praktika etike të forta për mbrojtjen e informacionit të studentëve (Bowers, 2011). Përfshirja e mekanizmave të mbrojtjes së të dhënave në sistemet edukative është thelbësore për sigurimin e mbrojtjes së informacionit të studentëve nga qasja e paautorizuar dhe për garantimin e përputhshmërisë me ligjet e privatësisë (Smith, 2022).

Ndërsa minimi i të dhënave edukative ofron njohuri të vlefshme mbi performancën dhe modelet e të mësuarit të studentëve, është thelbësore të arrihet një balancë mes këtyre përfitimeve dhe implementimit të masave të forta sigurie për të mbrojtur privatësinë e studentëve (Baker, 2019). Institucionet edukative duhet të vënë në fokus privatësinë dhe sigurinë duke krijuar politika të detajuara për mbrojtjen e të dhënave dhe duke siguruar që edukatorët dhe administratorët të jenë të trajnuar në këto praktika (O'Neil, 2020). Menaxhimi i efektshëm i të dhënave në edukim kërkon një qasje proaktive ndaj privatësisë dhe sigurisë, e cila përfshin kryerjen e auditimeve të rregullta dhe përditësimin e protokolleve të mbrojtjes së të dhënave (Martinez, 2023). Përdorimi etik i të dhënave edukative nënkupton jo vetëm mbrojtjen e PS të studentëve, por gjithashtu sigurimin e transparencës dhe marrjen e pëlqimit të informuar nga studentët dhe prindërit (Johnson, 2021).

Përputhja me ligjet dhe rregulloret e privatësisë është një komponent kyç i menaxhimit të të dhënave edukative, pasi ndihmon në ndërtimin e besimit dhe siguron mbrojtjen e të drejtave të studentëve (Harrison, 2022). Navigimi i peizazhit kompleks të privatësisë së të dhënave të studentëve kërkon një kuptim të thellë të kuadrit ligjor dhe politikave institucionale për të siguruar përputhshmërinë dhe për të mbrojtur informacionin e studentëve (Nelson, 2022).

Zbatimi i praktikave më të mira për mbrojtjen e të dhënave në ambientet edukative përfshin krijimin e politikave të qarta, zhvillimin e trajnimeve të rregullta dhe adoptimin e zgjidhjeve teknologjike për të zvogëluar rreziqet e sigurisë (Murphy, 2021).

4.1 Rreziqet dhe sfidat në ruajtjen e privatësisë gjatë përdorimit të teknologjisë

Evolucioni i shpejtë i teknologjisë paraqet sfida shumë të rëndësishme për ruajtjen e privatësisë personale duke përfshirë rrezikun e vazhdueshëm nga thyerjet e sigurisë si dhe qasjen e paautorizuar në informacionin privat (Jones, 2021).



Burimi: https://www.google.com/url?sa=i&url=https%3A%2F%2Fwww.dukagjini.com%2Ffanet-pozitive-dhe-negative-te-teknologjise-tek-femijet%2F&psig=AOvVaw2GqMGOSnf--EuSTIIVOAO8&ust=1726572030855000&source=images&cd=vfe&opi=89978449&ved=0CBQQjRxxFwoTCOjnv56sx4gDFQAAAAAdAAAAABA_I

Diskutimet etike mbi përdorimin e teknologjisë theksojnë domosdoshmërinë e zhvillimit të politikave të plota për privatësinë pra për të minimizuar rrezikun e mundshëm për informacionin personal (Green S. , 2022).

Sipas studimeve të UNICEF mbi përdorimin e internetit ndanë kategoritë të cilat konsiderohen me rreziqe dhe dëmtime:

- Abuzimi me vetveten dhe vetë-dëmtimi,
- Diskriminim,
- Ekspozimi ndaj materialeve të papërshtatshme,
- Ekspozimi ndaj përmbajtjes ekstremiste,
- Marketing jo i duhur ,
- Lojëra fati,
- Radikalizmi: bindje ideologjike (AKCESK, 2020).

Teknologjitë moderne kërkojnë gjithnjë një vlerësim të vazhdueshëm të praktikave etike si dhe strategjive për të mbrojtur privatësinë dhe për të parandaluar abuzimet e mundshme (Williams, 2023).

4.2 Avantazhet e teknologjisë në mësimnxënie

Mësimi i bazuar në multimedial është një qasje që e përdor teknologjinë për ta përmirësuar procesin e mësimi duke integruar imazhe dhe tekst, audio për të rritur kuptueshmërinë dhe vëmendjen (Mayer, Richard E., 2020).

Disa nga avantazhet e teknologjisë në mësimnxënie:

- Integrimi i teknologjisë në mësim nxënie mund të rrisë angazhimin e studentëve dhe të ofrojë mundësi për mësim më të personalizuar, duke kontribuar në përmirësimin e rezultateve të të nxënës (Hattie, 2019).
- Teknologjia edukative ofron mundësi për krijimin e mjediseve mësimore më dinamike dhe interaktive, të cilat ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të reja dhe të përmirësojnë performancën akademike (Mayer, 2021).
- Teknologjitë e avancuara mund të ofrojnë mundësi të reja për krijimin e përmbajtjes mësimore dhe për të personalizuar përvojën e të nxënës për çdo student (Luckin, 2020) .
- Përdorimi i teknologjisë në klasë mund të transformojë mënyrën se si studentët ndërveprojnë me materialet mësimore dhe të ofrojë mundësi të reja për mësim të avancuar dhe të bazuar në kërkim (Davidson, 2022).
- Teknologjitë e reja tashmë kanë potencialin të bëjnë mësimin më të angazhuar dhe efektiv si dhe duke ofruar mjete për mësim të personalizuar dhe përvoja të pasura për studentët (MacLeod, 2021).

5. Sfidat etike në teknologji

Sfidat kryesore etike që tashmë lidhen me teknologjinë sot është mënyra se si mund të i përdorim këto instrumentet digjitale për të ruajtur dhe promovuar virtytet morale. Teknologjia ka fuqinë të ndryshojë shumë mënyrën se si ta kuptojmë dhe përjetojmë moralin, dhe kjo kërkon një reflektim më të thellë mbi ndikimet e saj të mundshme (Vallor, 2016).

Disa nga sfidat të etikës në teknologji:

- Etika e informacionit kërkon një qasje të re për të kuptuar se si mund të menaxhojmë informacionin në mënyrë të drejtë dhe të ndershme. Teknologjia e informacionit ngre çështje të rëndësishme mbi privatësinë, transparencën dhe ndershmërinë e të dhënave, dhe ne duhet të jemi të vetëdijshëm për këto aspekte kur zhvillojmë dhe aplikojmë teknologji, për të siguruar që këto kontribuojnë në mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme në shoqëri.
- Nevoja për transparencë dhe mënyrën se si informacioni të menaxhohet kjo ndihmon për tu siguruar që përdoruesit të kenë të qartë të se si të dhënat e tyre përdoren. Ai argumenton se një sistem i hapur dhe transparent është thelbësor për të ruajtur besimin e përdoruesve.
- Përgjegjësin në përdorimin e teknologjive si dhe zhvilluesit e këtyre teknologjive duhet të jenë të ndërgjegjshëm për ndikimet që teknologjitë e tyre kanë tek individit dhe shoqëria (Floridi, 2013).

Pra mundë të themi se sfida etike tashmë është mbrojtja e të dhënave si dhe privatësia ku mos të shkelën të drejtat e nxënësve apo shoqërisë gjatë përdorimit të platformave të ndryshme apo mjeteve teknologjike shkollore ku nxënësit kyqën të kryejnë projekte apo detyra të ngjashme gjatë orës mësimore në programe të ndryshme.

5.1 Problematikat e përdorimit të teknologjisë për qëllime të gabueshme

Në një epokë ku informacioni është lehtësisht i arritshëm, është thelbësore që individët të zhvillojnë aftësi për të identifikuar burime të besueshme dhe për të kuptuar potencialin e keqpërdorimit të teknologjive. Përdorimi i teknologjisë për qëllime negative, si mashtrimi dhe manipulimi, është një problem në rritje që kërkon një qasje edukative që promovon mendimin kritik dhe etikën digjitale. Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e një shoqërie më të informuar dhe të përgjegjshme (Rheingold, 2012).

Të rinjtë sot janë të rrethuar nga teknologjia dhe shpesh nuk e kuptojnë si ta përdorin atë në mënyrë të sigurt. Një problem serioz është përdorimi i saj për qëllime të gabuara, si plagjiatura ose shpërndarja e përmbajtjeve të papërshtatshme.

Prandaj, është thelbësore që edukatorët të krijojnë një ambient ku të rinjtë mund të mësojnë si ta përdorin teknologjinë në mënyrë etike dhe të përgjegjshme, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë njohuri dhe aftësi për një përdorim të shëndetshëm të këtyre mjeteve (Prensky, 2001).

Teknologjia na ofron mundësi të jashtëzakonshme për të komunikuar, por ndonjëherë harrojmë se bisedat e vërteta janë ato që na lidhin si njerëz.

Përdorimi i teknologjisë për qëllime negative, si ngacmimi online ose shpërndarja e informacionit të rremë, ilustron se si mund të keqpërdorim këto mjete dhe të humbasim lidhjet njerëzore. Prandaj, edukatorët dhe prindërit duhet të bashkëpunojnë për t'i ndihmuar të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të ndërtimit të marrëdhënieve autentike (Turkle, 2015).

KAPITULLI III

6. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

6.1 Metodatat e hulumtimit

Në këtë punim, ne kemi përdorur metodën sasiore përmes aplikimit të pyetësorëve si një mjet kryesor për mbledhjen e të dhënave. Kjo metodë na ka lejuar të përfshijmë një numër të gjerë respondentësh, duke siguruar kështu një mostër të larmishme që pasqyron mendimet dhe përvojat e ndryshme të nxënësve.

Përveç kësaj, metoda përshkruese ka luajtur një rol thelbësor në procesin e hulumtimit. Ajo na ka ndihmuar të analizojmë dhe interpretojmë informacionin e mbledhur në një mënyrë sistematike, duke na mundësuar që të nxjerrim konkluzione të arsyeshme dhe të strukurojmë gjetjet tona në një format të qartë e të kuptueshëm.

Hulumtimi është mbështetur në një literaturë të gjerë nga autorë të ndryshëm dhe punime shkencore relevante për temën në fjalë. Këto burime kanë ofruar një bazë solide teorike që na ka ndihmuar të kuptojmë kontekstin e temës, si dhe të identifikojmë dhe analizojmë variablat e rëndësishëm që lidhen me objektivat e punimit. Kjo qasje ka kontribuar në forcimin e argumenteve tona dhe në rritjen e besueshmërisë së rezultateve të arritura.

6.2 Instrumentet e hulumtimit

Instrumenti kryesor i hulumtimit në këtë punim është pyetësi, i cili është shpërndarë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek nxënësit. Kjo qasje ka ofruar mundësinë për një ndërveprim më të afërt me nxënësit, duke kontribuar në rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të mbledhura. Duke qenë se nxënësit kanë pasur mundësinë të plotësojnë pyetësin në ambient shkollor dhe në një kontekst të qetë, kjo ka ndihmuar në minimizimin e ndjenjës së ankthit ose presionit, që ndonjëherë mund të shoqërojë mbledhjen e informacionit.

Pyetësi përfshinte një kombinim pyetjesh të hapura dhe të mbyllura, të cilat lejuan një analizë të thellë dhe të gjithanshme të mendimeve dhe përvojave të nxënësve. Pyetjet e mbyllura ofrojnë mundësinë për të mbledhur të dhëna numerike dhe për të kryer analiza statistike, ndërsa pyetjet e hapura inkurajojnë nxënësit të shprehin mendimet e tyre në mënyrë më kreative dhe të detajuar. Kjo kombinim i metodave ka krijuar një pasqyrë të plotë të qëndrimeve dhe ndjenjave të nxënësve, duke lejuar hulumtuesit të zbulojnë nuanca dhe thellësi në përgjigjet e tyre.

Përdorimi i të dyjave llojeve të pyetjeve ka ndihmuar në mbledhjen e informacionit cilësor dhe sasior. Kjo jo vetëm që ka pasuruar rezultatet e hulumtimit, por gjithashtu ka ofruar një bazë të fortë për interpretimin e të dhënave, duke lejuar që gjetjet të ndihmojnë në formulimin e rekomandimeve të dobishme për praktikën arsimore. Kështu, hulumtimi ka arritur të krijojë një kuptim të qartë dhe të plotë të aspekteve të ndryshme të përvojës së nxënësve, duke nxjerrë në pah elementët kyç që ndikojnë në arritjet dhe angazhimin e tyre në procesin e mësimi.

6.3 Populacioni dhe mostra

Populacioni i këtij hulumtimi përfshin nxënësit e shkollës, të cilët përfaqësojnë një grup të rëndësishëm në kontekstin e arsimimit dhe zhvillimit të tyre personal. Nga ky popullim, mostra është përzgjedhur nga 224 nxënës, të cilët janë anketuar përmes intervistave të realizuara me pyetësorë. Kjo përzgjedhje e mostrës është bërë me qëllim që të përfshijmë një larmi të gjerë përvojash dhe perspektivash, duke reflektuar kështu diversitetin e mendimeve që ekzistojnë brenda grupit të nxënësve.

Pyetësorët e përdorur në këtë hulumtim përmbanin një kombinim pyetjesh të hapura dhe të mbyllura, duke siguruar një gamë të gjerë informacioni që mundëson një analizë të thellë të mendimeve dhe përvojave të nxënësve. Pyetjet e mbyllura ndihmojnë në grumbullimin e të dhënave të strukturuar, duke lejuar krahasimin dhe analizat statistike, ndërsa pyetjet e hapura ofrojnë mundësinë që nxënësit të shprehin mendimet e tyre në një mënyrë më personale dhe të detajuar. Kjo kombinim i llojeve të pyetjeve ka ndihmuar në pasurimin e të dhënave, duke lejuar hulumtuesit të kuptojnë më mirë nuancat e mendimeve dhe ndjenjave të nxënësve.

Kjo qasje ka mundësuar grumbullimin e të dhënave të besueshme dhe relevante për temën e hulumtimit, duke garantuar që informacioni i mbledhur është i saktë dhe përfaqësues. Kjo është thelbësore për sigurimin e një baze të fortë për interpretimin e gjetjeve dhe për nxjerrjen e konkluzioneve të arsyeshme. Për më tepër, procesi i realizimit të intervistave ka ndihmuar në krijimin e një ambienti ku nxënësit ndihen të lirë për të ndarë mendimet e tyre, duke kontribuar në mbledhjen e informacionit cilësor që është i rëndësishëm për të kuptuar kontekstin e përvojave të tyre arsimore. Kështu, ky hulumtim ka arritur të krijojë një pasqyrë të qartë dhe të plotë të perspektivave të nxënësve, duke ofruar njohuri të vlefshme për praktikën arsimore dhe politikën që lidhen me to.

6.4 Procedura e mbledhjes dhe analizës së të dhënave

Procedura e mbledhjes së të dhënave përfshinte shpërndarjen e pyetësorëve tek 224 nxënës, të cilët iu nënshtruan një procesi të strukturuar intervistimi. Kjo qasje e organizuar garanoi një përvojë sistematike për çdo nxënës, duke siguruar që informacioni të mbledhesh në mënyrë të plotë dhe të qartë. Pyetësorët përmbanin një kombinim pyetjesh të hapura dhe të mbyllura, duke mundësuar një grumbullim të larmishëm të informacionit që pasqyronte një gamë të gjerëperspektivash dhe mendimesh.

Gjatë këtij procesi, nxënësit u inkurajuan të japin përgjigje të sinqerta dhe të hapura, duke krijuar kështu një ambient ku ata ndiheshin të lirë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre pa frikë nga gjykimi. Kjo ishte thelbësore për të garantuar saktësinë e të dhënave të mbledhura, pasi përgjigjet e sinqerta kontribuuan në krijimin e një pasqyre të besueshme të përvojave të tyre.

Pas përfundimit të procesit të mbledhjes, të dhënat u analizuan përmes metodave statistikore dhe kualitative. Për pyetjet e mbyllura, u përdorën analiza statistikore për të nxjerrë përfundime të qarta dhe të matshme, duke mundësuar identifikimin e tendencave dhe modeleve të qarta brenda përgjigjeve të nxënësve. Këto analiza ndihmuan në vizualizimin e rezultateve në një format të qartë dhe të kuptueshëm, duke ofruar mundësinë për krahasime të lehta.

Nga ana tjetër, për pyetjet e hapura, u realizua një kodim tematik për të identifikuar modelet dhe temat kryesore që dolën nga përgjigjet e nxënësve. Kjo qasje ka kontribuar në një interpretim të plotë dhe të thellë të rezultateve, duke ofruar një kuptim më të mirë të aspekteve të hulumtimit dhe të ndikimeve që ato kanë në përvojën arsimore të nxënësve. Kështu, hulumtimi ka arritur të sjellë një pasqyrë të qartë dhe të ndihmojë në formulimin e rekomandimeve të vlefshme për përmirësimin e praktikave arsimore.


KAPITULLI IV

7. PREZENTIMI, ANALIZIMI DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE

7.1 Prezantimi dhe analizimi i rezultateve

Në këtë kapitull, prezantohen rezultatet e studimit mbi etikën e përdorimit të teknologjisë dhe efektin e saj në mësimnxënie në shkollat e mesme të ulëta në komunën e Gjilanit. Intervistat janë realizuar me 224 nxënës në 3 shkolla të ndryshme, përfshinë pyetje lidhur me përdorimin e teknologjisë, perceptimet mbi etikën. Në këtë pjesë, analizohen rezultatet e mbledhura për të ofruar një kuptim të thellë mbi përdorimin e teknologjisë dhe ndikimin e saj në mësim nxënie si dhe interpretohen nëpërmjet grafikëve.


Grafiku 1. Gjinia



Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Në grafikun nr.1 i ndarjes gjinore të nxënësve në studimin tonë tregon se nga 224 nxënës të anketuar, 106 janë meshkuj dhe 118 janë femra. Ky përbërje gjinore reflekton një përqindje të dukshme më të lartë të femrave në raport me gjininë mashkullore. Pra, femrat janë 5.36% më shumë në përqindje në raport me meshkujt.


Grafiku 2. Mosha



Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku nr. 2 ofron një pasqyrë të qartë mbi përbërjen e grup moshës së nxënësve të intervistuar. Grupi i moshës 10-12 vjeç përfshin 90 nxënës, që përbën 40.18% të totalit, duke treguar një prani të konsiderueshme të fëmijëve në këtë kategori. Në anën tjetër, grup moshë 12-14 vjeç ka numrin më të lartë me 125 nxënës, që përfaqëson 55.80% të gjithsej, duke sugjeruar një përqendrim të lartë të nxënësve në këtë grup. Pjesa më e vogël, moshë 15 vjeçare, përfshin vetëm 9 nxënës ose 4.02% të totalit, duke theksuar se ky grup moshe është më pak i përfaqësuar në studim. Këto të dhëna sugjerojnë një shpërndarje të dukshme të moshave dhe mund të japin një kontekst të rëndësishëm për analizat e mëtejshme mbi karakteristikat dhe nevojat e nxënësve në këtë grup moshë.


Grafiku 3. Emri Shkollës



Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku nr. 3 paraqet të dhënat nga hulumtimi ynë mbi tri shkollat e Gjilanit, duke ilustruar numrin e nxënësve të intervistuar. Në shkollën 'Thimi Mitko' janë intervistuar 73 nxënës, ndërsa në 'Selami Hallaçi' ky numër arrin në 75. Më së shumti janë intervistuar në shkollën 'Musa Zjama' ku numrin arrin në 76 nxënës.

Grafiku 4. A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja




Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku nr.4 tregon përgjigjet e nxënësve të shkollës '**Thimi Mitko**', nga të dhënat, rezulton se 4 nxënës (5.48%) nuk pajtohen fare me këtë ide, ndërsa 8 nxënës (10.96%) shprehen se nuk pajtohen. Në anën tjetër, 43 nxënës (58.90%) pajtohen me idenë se teknologjia ka ndikuar pozitivisht, ndërsa 18 nxënës (24.66%) e përkrahin plotësisht këtë pikëpamje. Këto rezultate sugjerojnë se shumica e nxënësve në 'Thimi Mitko' besojnë se përdorimi i teknologjisë në mësim ka një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e njohurive të tyre.

Grafiku tregon përgjigjet e nxënësve të shkollës 'Selami Hallaçi'. Nga të dhënat, rezulton se 9 nxënës (12%) nuk pajtohen fare me këtë ide, ndërsa 17 nxënës (22.67%) shprehen se nuk pajtohen. Në anën tjetër, 16 nxënës (21.33%) pajtohen me idenë, ndërsa 33 nxënës (44%) e përkrahin plotësisht këtë pikëpamje. Këto rezultate sugjerojnë se një shumicë e konsiderueshme besojnë se përdorimi i teknologjisë në mësim ka një ndikim pozitiv në cilësinë e njohurive të tyre.

Grafiku tregon përgjigjet e nxënësve të shkollës 'Musa Zajmi'. Sipas të dhënave, 4 nxënës (5.26%) nuk pajtohen fare me këtë ide, ndërsa 7 nxënës (9.21%) shprehen se nuk pajtohen. Në anën tjetër, 38 nxënës (50%) pajtohen me idenë se teknologjia ka një ndikim pozitiv, dhe 27 nxënës (35,53%) e përkrahin plotësisht këtë pikëpamje.

Grafiku 5.A mendoni që përdorimi i teknologjisë ka ndryshuar mënyrën si mësoni, veçanërisht në krahasim me mënyrën tradicionale të mësimin?




Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku nr.5 tregon përgjigjet e nxënësve të shkollës '**Thimi Mitko**' nga të dhënat se 3 nxënës (4.1%) ky numër i vogël nxënësish nuk shohin asnjë ndikim të teknologjisë ndërsa me nuk pajtohem janë 9 nxënës (12.3%) ky grup nxënësish tregon një dyshim mbi përfitimet e teknologjisë, pajtohem janë 44 nxënës (60.3%) shumica e madhe e nxënësve e sheh teknologjinë si një faktor pozitiv në mësim ndërsa me pajtohem plotësisht janë 17 nxënës (23.3%).

Grafika e rezultateve nga '**Selami Hallaçi**' tregon se 2 nxënës nuk pajtohen fare (rreth 2.7%) që tregon se disa nxënës ende preferojnë mënyrat tradicionale të mësimin dhe nuk shohin ndikim nga teknologjia, nuk pajtohen 20 nxënës apo (rreth 27.4%) ndërsa 34 nxënës (rreth 46.6%) pajtohen se teknologjia ka ndikuar pozitivisht në mënyrën e të mësuarit, pajtohem plotësisht 19 nxënës (25.7%) dhe është i bindur se teknologjia është esenciale për procesin e të mësuarit.

Grafika e rezultateve nga '**Musa Zajmi**' tregon se një shumicë e konsiderueshme e nxënësve, rreth 75%, e pranojnë se teknologjia ka ndryshuar mënyrën si ata mësojnë. Saktësisht, 47 nxënës (62%) kanë shprehur se pajtohen me ndikimin e teknologjisë, ndërsa 16 nxënës (13%) pajtohen plotësisht. Në anën tjetër, një numër më i vogël nxënës 3 nuk e mbështesin teknologjinë.

Grafiku 6. A keni vërejtur ndonjë ndryshim në motivin tuaj për të mësuar kur teknologjia përdoret në mësim




Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku nr.6 tregon përgjigjet e nxënësve të shkollës '**Thimi Mitko**' ku shumica e nxënësve (35 nxënës, 46.5%) kanë shprehur se përdorimi i teknologjisë në mësim e rrit motivimin e tyre për të mësuar ndërsa një numër i konsiderueshëm nxënësish (33 nxënës, 43.5%) kanë zgjedhur "Mesatarisht," duke sugjeruar se ndihma e teknologjisë është e dukshme, por ndoshta jo gjithmonë e mjaftueshme dhe 5 nxënës (6.5%) kanë thënë "JO," që tregon se për një grup të vogël nxënësish, teknologjia nuk ka pasur një efekt të dukshëm në motivimin e tyre.

Grafika e rezultateve nga '**Selami Hallaçi**' tregon se (35 nxënës, 67.3%) kanë zgjedhur "Mesatarisht," duke sugjeruar se përdorimi i teknologjisë ka një ndikim të dukshëm në motivimin e tyre, por ndoshta jo gjithmonë të plotë. Pjesa tjetër e nxënësve, 24 nxënës (46.2%), kanë shprehur se përdorimi i teknologjisë e rrit motivimin e tyre për të ndërsa një grup i vogël, 16 nxënës (30.8%), kanë thënë "JO,".

Grafika e rezultateve nga '**Musa Zajmi**' tregon 14 nxënës (22.6%) kanë shprehur se nuk kanë vërejtur ndonjë ndryshim në motivimin e tyre kur teknologjia përdoret në mësim, 36 nxënës (58.1%) kanë zgjedhur "Mesatarisht," duke sugjeruar se përdorimi i teknologjisë ka një ndikim të dukshëm në motivimin e tyre si dhe 26 nxënës (41.9%) kanë shprehur se përdorimi i teknologjisë e rrit motivimin e tyre për të mësuar, duke reflektuar një perceptim pozitiv.

Grafiku 7. A mendoni se teknologjia mundë të ndihmojë për të përmirësuar cilësinë e mësimi dhe për të arritur qëllimet e arsimit?



Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku nr.7 tregon përgjigjet e nxënësve të shkollës '**Thimi Mitko**' numri i madh i nxënësve që pajtohen janë (33) dhe ata që pajtohen plotësisht janë (24) sugjeron se shumica e tyre besojnë se teknologjia ka potencialin për të ndihmuar në mësimdhënie. Kjo është një tregues pozitiv, pasi tregon se nxënësit janë të hapur ndaj inovacioneve dhe përmirësimeve që teknologjia mund të sjellë. Në anën tjetër, vetëm 5 nxënës që nuk pajtohen si dhe 11 që nuk pajtohen fare shprehin mendim të kundërt, çka sugjeron se shqetësimet për teknologjinë janë të kufizuara dhe ndoshta lidhen me eksperiencat individuale negative ose frikën nga ndryshimi.

Duke marrë parasysh rezultatet, duket se një shumicë e madhe e nxënësve në shkollën "**Selami Hallaçi**" besojnë se teknologjia ka potencialin për të përmirësuar cilësinë e mësimi. Vetëm 15 nxënës nuk pajtohen me këtë mendim, ndërsa pjesa më e madhe (60 nxënës) e mbështet idenë e integritit të teknologjisë në procesin mësimor. Ky rezultat sugjeron se nxënësit janë të hapur ndaj ndryshimeve dhe inovacioneve që teknologjia ofron.

Kjo tregon se nxënësit e shkollës "**Musa Zajmi**" kanë një mbështetje shumë të fortë për rolin e teknologjisë në përmirësimin e cilësisë së mësimi. Vetëm 11 nxënës nuk pajtohen me idenë se teknologjia mund të ndihmojë, ndërsa shumica prej 65 nxënësve e shohin atë si një mundësi.

8. Çfarë përparësish mendoni se vijnë nga përdorimi i teknologjisë në mësim në krahasim me metodat tradicionale?

Në shkollën "Thimi Mitko," rezultatet e pyetësorit tregojnë se 60% e nxënësve besojnë se teknologjia ndihmon në përmirësimin e procesit mësimor. Kjo tregon një mbështetje të konsiderueshme për integrimin e teknologjisë në arsimin e sotëm dhe e thekson rëndësinë e saj si mjet për të përmirësuar angazhimin dhe efektivitetin e mësimin. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se 40% e nxënësve shprehin shqetësime se nuk mund të mësojnë në të njëjtën kohë. Kjo tregon se disa nxënës ndihen të mbingarkuar ose të shpërqendruar nga teknologjia, gjë që mund të ndikojë negativisht në përvojën e tyre mësimore.


Kjo ndarje në mendime sugjeron se, për të arritur një integrim të suksesshëm të teknologjisë në klasë, është e nevojshme të adresohen shqetësimet e nxënësve dhe të krijohet një mjedis që e mbështet mësimin në mënyrë efektive.

Në shkollën "Musa Zajmi," rezultatet e pyetësorit tregojnë një diversitet në mendimet e nxënësve rreth përfitimeve të teknologjisë në procesin mësimor. Prej 26 nxënësve që kanë deklaruar se nuk dinë çfarë përfitimesh u sjell teknologjia, kjo sugjeron se disa nxënës ndihen të painformuar ose skeptikë ndaj ndikimit të saj. Nga ana tjetër, 40 nxënës kanë shprehur se e kuptojnë teknologjinë dhe se ajo i ndihmon të mësojnë më shumë. Kjo tregon se një pjesë e madhe e nxënësve e vlerësojnë teknologjinë si një mjet të dobishëm për përmirësimin e procesit të të mësuarit.

Përveç kësaj, 9 nxënës kanë deklaruar se teknologjia u lejon të lexojnë libra më shumë, duke theksuar se blerja e librave fizike është e shtrenjtë. Këto rezultate sugjerojnë se është e nevojshme të informohen më mirë nxënësit mbi përfitimet e teknologjisë dhe të krijohet një mjedis që të inkurajojë përdorimin e saj në mënyrë efektive.

Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

9. A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe sigurinë në internet?



Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku nr.8 tregon përgjigjet e nxënësve të shkollës '**Thimi Mitko**' kjo tregon se shumica e nxënësve (46) kanë një qëndrim pozitiv për ndikimin e teknologjisë në ndërgjegjen e tyre etike në lidhje me privatësinë dhe sigurinë në internet. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm (27) ndihen ndryshe. Kjo situatë sugjeron nevojën për më shumë diskutime dhe edukim mbi etiket e teknologjisë dhe rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë.

Përgjigjet e nxënësve të shkollës '**Selami Hallaçi**' tregon se një numër i madh nxënësish (54) nuk ndihen se teknologjia ka pasur ndikim pozitiv në ndërgjegjen e tyre etike lidhur me privatësinë dhe sigurinë në internet. Ndërsa 41 nxënës (26 që pajtohen dhe 15 që pajtohen plotësisht) e shohin teknologjinë si një mjet që ka ndikuar në mënyrë pozitive. Kjo përqindje e lartë e nxënësve që nuk pajtohen sugjeron se mund të ketë një mungesë të vetëdijes ose informacionit mbi çështjet e privatësisë dhe sigurisë në internet. Kjo është një mundësi për shkollën që të organizojë seminare, punëtori ose diskutime mbi etikën në përdorimin e teknologjisë.

Përgjigjet e nxënësve të shkollës '**Musa Zajmi**' tregon se 53 nxënës mendojnë se përdorimi i teknologjisë ka ndikuar pozitivisht në ndërgjegjen e tyre etike, veçanërisht lidhur me privatësinë dhe sigurinë në internet ndërsa 23 nxënës ndihen se teknologjia nuk ka pasur një ndikim të tillë.

10. A keni ndonjë shqetësim për çështjet etike në lidhje me përdorimin e teknologjisë në mësim? Nëse po cilat janë ato dhe si mendoni se mundë të adresohen?

Duke analizuar përgjigjet nga shkolla "Thimi Mitko" për pyetjen në lidhje me shqetësimet etike mbi përdorimin e teknologjisë në mësim 25 nxënës nuk kanë dhënë mendim fare ndërsa 48 nxënës shprehin shqetësim për privatësinë dhe të dhënat e tyre, veçanërisht për fotografitë.


Këto rezultate tregojnë një ndjeshmëri të lartë për çështjet e privatësisë mes nxënësve. Shifrat sugjerojnë se një numër i konsiderueshëm Nxënësit janë të vetëdijshëm për rreziqet që mund të vijnë nga ndarja e të dhënave të tyre personale, sidomos në kontekstin e fotografive, që shpesh ndahen dhe përdoren në mënyra të papritura. Mungesa e mendimeve nga 25 nxënësit e tjerë mund të tregojë se disa prej tyre nuk kanë ndjerë nevojën për të shprehur shqetësime ose ndoshta nuk janë të vetëdijshëm për çështjet që lidhen me privatësinë.

Duke analizuar përgjigjet nga shkolla "Selami Hallaçi" (8 nxënës) nuk janë përgjigjur fare 7 nxënës që shprehin shqetësim për bulëzimin janë një tregues se ky fenomen është një çështje e rëndësishme për disa nxënës. Kjo është diçka që shkolla duhet ta marrë seriozisht dhe të zhvillojë strategji për të adresuar këtë problem, si punëtori dhe aktivitete për ndihmën e viktimave dhe edukimin e nxënësve për pasojat e bulëzimit si dhe 60 nxënës që thonë se nuk kanë shqetësime për privatësinë e të dhënave të tyre sugjerojnë se ata ndihen të sigurt në lidhje me mënyrën e përdorimit të dhënave të tyre.

Duke analizuar përgjigjet nga shkolla "Musa Zajmi" një numër i konsiderueshëm (26 nxënës) ndihen të shqetësuar për çështjet etike, që tregon se ndjenjat e tyre për privatësinë, sigurinë dhe përdorimin e teknologjisë janë të rëndësishme. Nga ana tjetër, 50 nxënës që nuk kanë shprehur shqetësime sugjerojnë se ata ndihen të sigurt dhe të qetë me mënyrën e përdorimit të teknologjisë në shkollë.

Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Grafiku 11. A mendoni se është e rëndësishme që teknologjia të përdoret në mënyrë etike në mësim?



Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

Shkolla "Thimi Mitko" të dhënat tregojnë se 58 nxënës pajtohen për rëndësinë e përdorimit etik të teknologjisë, që tregon një ndërgjegjësim të mirë për çështjet etike ndërsa 15 nxënës që nuk pajtohen mund të jenë një tregues i shqetësimeve specifike, si mungesa e informacionit apo përvojat negative. Kjo është një mundësi për shkollën të zhvillojë aktivitete për të adresuar këto shqetësime.

Shkolla "Selami Hallaqi" me 67 nxënës që pajtohen, kjo tregon një mbështetje të fortë për përdorimin etik të teknologjisë. Kjo sugjeron se shkolla ka krijuar një mjedis të favorshëm për diskutim mbi etikën ndërsa një numër i vogël i Nx që nuk pajtohen (8) sugjeron se ka hapësirë për përmirësim, ndoshta duke ofruar më shumë informacion ose burime në lidhje me etikën e teknologjisë.

Shkolla "Musa Zajmi" nga të dhënat tregojnë se 68 nxënës pajtohen për rëndësinë e përdorimit etik të teknologjisë, duke reflektuar një mendësi pozitive dhe të hapur për diskutime mbi këtë temë dhe me 8 nxënës që nuk pajtohen fare.

12. Çfarë do të dëshironit të ndryshonte në përdorimin e teknologjisë në shkollën tuaj?

Shkolla "Thimi Mitko" nga të dhënat tregojnë se, 80% e nxënësve shprehën dëshirën për më shumë hapësirë në kabinet dhe një përdorim më intensiv të tij, pasi aktualisht kalojmë shumë pak kohë atje. Ata sugjerojnë që të rinovohen pajisjet, duke përfshirë laptopë të rinj dhe kompjuterë, pasi ndihen se shkolla është mbrapa me teknologjinë. Gjithashtu, kërkojnë që të instalohen projektorë të rinj. Në kontrast, 20% e nxënësve vlerësojnë aktualisht përdorimin e teknologjisë si të kënaqshme.

Shkolla "Selami Hallaçi" nga të dhënat tregojnë se, një grup prej 75 nxënësish, 30 nxënës janë shprehur se nuk dëshirojnë të ketë ndryshime në përdorimin e teknologjisë, ndërsa 4 nxënës nuk janë të sigurt se çfarë duhet të ndryshohet. Një grup prej 30 nxënësish sugjerojnë që të kenë laptopë nëpër klasa dhe kompjuterë me standarde më të larta, duke theksuar se pajisjet aktuale janë shumë të vjetra. Ata gjithashtu kërkojnë tabela digjitale për të përmirësuar mësimdhënien. Në anën tjetër, 11 nxënës mendojnë se teknologjia duhet të jetë më e avancuar dhe sugjerojnë përdorimin e kabinetit të teknologjisë, i cili aktualisht nuk po përdoret. Ata theksojnë se metodat tradicionale të mësimdhënies janë dominuese dhe ndihen të pakësuar në informimin rreth përdorimit të teknologjisë. Këto rezultate sugjerojnë një nevojë për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe përfshirjen e më shumë metodave moderne të mësimdhënies në shkollë.

Shkolla "Musa Zajmi" Në shkollën "Musa Zajmi", 65% e nxënësve kanë shprehur nevojën për të instaluar projektorë dhe pajisje të tjera teknologjike, duke theksuar se këto mjete do të përmirësonin procesin e mësimdhënies. Në anën tjetër, 40% e nxënësve mendojnë se aktualisht situata është e kënaqshme. Këto rezultate sugjerojnë se ka një interes të fortë për të modernizuar infrastrukturën teknologjike në shkollë, duke e bërë mësimin më interaktiv dhe efikas.

Burimi: Nga pyetësi, Kandidatja

7.2 Argumentimi i pyetjeve kërkimore

Si një komponent i rëndësishëm i temës sonë të diplomës, argumentimi i pyetjeve kërkimore është thelbësor. Në vazhdim, do të përpiqemi t'i japim përgjigje këtyre pyetjeve me ndihmën e pyetësorit, veçanërisht duke analizuar përgjigjet e marra. Pyetjet hulumtuese janë si më poshtë:

1. A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja?
2. A e perceptojnë teknologjinë si një mjet për të përmirësuar cilësinë e mësimi?
3. A ndikon përdorimi i teknologjisë në mësim në aspektin e cilësisë së informacionit dhe burimeve të disponueshme për nxënësit?
4. A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe sigurinë në internet?
5. A mund të ketë teknologjia ndikime negative në aftësinë e nxënësve për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme dhe respektuese në ambientin mësimor?

-Pytja e parë kërkimore: A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja?

Përgjigje

Kësaj pyetje kërkimore përgjigjen do t'ia japin duke u bazuar në pyetësorin tonë, në pyetjen e katërt (P,4).

Përgjigjet e anketa tregojnë se përdorimi i teknologjisë në mësim ka pasur një ndikim pozitiv në cilësinë e njohurive të studentëve. Nga 224 nxënës, 175 (78.13%) janë shprehur se pajtohen me këtë pohim, ndërsa vetëm 49 (21.88%) nuk pajtohen. Kjo statistikë sugjeron se shumica e studentëve vlerësojnë teknologjinë si një mjet të dobishëm për përmirësimin e procesit mësimor dhe thellimin e njohurive të tyre.

-Pytja e dytë kërkimore: A e perceptojnë teknologjinë si një mjet për të përmirësuar cilësinë e mësimi?

Përgjigje

Kësaj pyetje kërkimore përgjigjen do t'ia japim duke u bazuar në rezultatet e pyetësorit tonë, në pyetjen e shtatë (P,7).

Përgjigjet e anketës ofrojnë një pamje optimiste mbi ndikimin e teknologjisë në procesin e mësimi. Me 82% të nxënësve që e përkrahin idenë se teknologjia ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së njohurive të tyre, është e qartë se shumica e studentëve e shohin atë si një mjet efektiv për të thelluar mësimin. Kjo sugjeron se teknologjia ndihmon në angazhimin e studentëve, ofron akses në burime të ndryshme dhe inkurajon një metodë më interaktive të mësimi.

Pjesa më e vogël e studentëve (18%) që nuk pajtohen me këtë pohim mund të tregojë përvojat e ndryshme individuale. Kjo mund të ndodhë për shkak të mënyrës se si përdoret teknologjia në klasë, ose për shkak të sfidave që disa nxënës mund të përballen në përdorimin e saj.

-Pytja e tretë kërkimore: A ndikon përdorimi i teknologjisë në mësim në aspektin e cilësisë së informacionit dhe burimeve të disponueshme për nxënësit?

Përgjigje

Kësaj pyetje kërkimore përgjigjen do t'ia japin duke u bazuar në pyetësorin tonë, në pyetjen e pestë dhe shtatë (P5,7).

Përdorimi i teknologjisë në mësim ka një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e informacionit dhe burimeve të disponueshme për nxënësit. Të dhënat që tregojnë se 75% nxënës mendojnë se teknologjia ka një ndikim pozitiv dhe 25% nxënës nuk pajtohen, sugjerojnë se një shumicë e madhe e nxënësve e shohin teknologjinë si një faktor pozitiv në arsim, ndërsa pjesa tjetër kanë një qasje kritike ose negative ndaj saj.

Kjo ndarje tregon një prirje të fortë për t'u pajtuar me përfitimet që sjell teknologjia, siç janë aksesimi më i lehtë në informacion, materialet edukative të ndryshme dhe angazhimi më i lartë në procesin e të mësuarit.

-Pytja e katër kërkimore: A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike, veçanërisht në lidhje me privatësin dhe sigurinë në internet?

Përgjigje

Kësaj pyetje kërkimore përgjigjen do t'ia japim duke u bazuar në rezultatet e pyetësorit tonë, në pyetjen e tetë (P,8).

Më konkretisht, 140 nxënës që janë pajtuar sugjerojnë se një shumicë e konsiderueshme ndjejnë se përdorimi i teknologjisë në mësim ka rritur ndërgjegjen e tyre për çështjet e privatësisë dhe sigurisë në internet. Kjo mund të lidhet me faktin se teknologjia shpesh i ekspozon ata ndaj informacionit mbi rreziqet që lidhen me përdorimin e saj, si dhe me rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. Nga ana tjetër, 84 nxënës që nuk janë pajtuar mund të ndjejnë se përdorimi i teknologjisë nuk ka ndikuar ndjeshëm në ndërgjegjen e tyre etike, ose ndoshta ata ndihen të painformuar për rreziqet që lidhen me privatësinë dhe sigurinë.

-Pytja e pestë kërkimore: A mund të ketë teknologjia ndikime negative në aftësinë e nxënësve për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme dhe respektuese në ambientin mësimor?

Përgjigje

Kësaj pyetje kërkimore përgjigjen do t'ia japin duke u bazuar në pyetësorin tonë, në pyetjen e dhjetë (P,10).

Në lidhje me përdorimin e teknologjisë në mësim, të dhënat sugjerojnë një ndarje të qartë në mendimet e nxënësve. Nga 224 nxënës të intervistuar, 81 prej tyre shprehin shqetësime, ndërsa 111 nuk kanë shprehur ndonjë shqetësim. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se 32 nxënës nuk kanë dhënë asnjë mendim, që mund të tregojë indiferencë ose mungesë njohurie për çështjet etike.

7.3 Testimi i hipotezave

Në këtë studim, për testimin e hipotezave përdorëm Bayesian Binomial Test për të krahasuara përgjigjet e nxënësve lidhur me mbështetjen për dy hipoteza: hipotezën null (H_0) dhe hipotezën alternative (H_1). Ky test na lejon të vlerësojmë se sa mbështetje ka secila hipotezë në bazë të dhënave të mbledhura.

H_0 : Integrimi i teknologjisë nuk përmirëson cilësinë dhe efektivitetin e mësimit.

H_1 : Integrimi i teknologjisë përmirëson cilësinë dhe efektivitetin e mësimit.

Binomial Test

Binomial Test

Variable	Level	Counts	Total	Proportion	p	95% CI for Proportion	
						Lower	Upper
A mendoni se teknologjia mund të ndihmojë për të përmirësuar cilësinë e mësimit?	PO	182	224	0.813	< .001	0.764	1.000
	JO	42	224	0.188	1.000	0.146	1.000
A keni vërejtur ndryshim në motivin tuaj për të mësuar kur teknologjia përdoret në mësimit?	JO	41	224	0.183	1.000	0.142	1.000
	PO	183	224	0.817	< .001	0.769	1.000
A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësimit ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja?	PO	175	224	0.781	< .001	0.731	1.000
	JO	49	224	0.219	1.000	0.174	1.000

Note. For all tests, the alternative hypothesis specifies that the proportion is greater than 0.5.

Tabela 1. Të Dhënat e Hipotezës H_1

Rezultatet e Testit Binomial:


A mendoni se teknologjia mund të ndihmojë për të përmirësuar cilësinë e mësimit?

- Përgjigja "Po": 182 nga 224 nxënës (proporcioni 0.813)
- Përgjigja "Jo": 42 nga 224 nxënës (proporcioni 0.188)
- p-vlera: < 0.001
- Intervali i Besueshmërisë (95% CI) për "Po": [0.764, 1.000]

Interpretimi: Rezultatet tregojnë se një shumicë e madhe e nxënësve (81.3%) besojnë se teknologjia mund të përmirësojë cilësinë e mësimit, me një p-vlerë të vogël (< 0.001), që tregon mbështetje të fortë për H_1 që proporcioni i përgjigjeve "Po" është më i madh se 0.5 .


Descriptives Plots

A mendoni se teknologjia mund të ndihmojë për të përmirësuar cilësinë e mësimit?



Pra shumica e nxënësve e mbështesin mendimin se teknologjia ka një ndikim shumë pozitiv në cilësinë e mësimit.


A keni vërejtur ndonjë ndryshim në motivin tuaj për të mësuar kur teknologjia përdoret në mësime?



- Përgjigja "Po": 183 nga 224 nxënës (proporcioni 0.817)
- Përgjigja "Jo": 41 nga 224 nxënës (proporcioni 0.183)
- p-vlera: < 0.001
- Intervali i Besueshmërisë (95% CI) për "Po": [0.769, 1.000]

Një përqindje e konsiderueshme e nxënësve (81.7%) raportojnë se përdorimi i teknologjisë ka ndikuar në motivimin e tyre për të mësuar. Po ashtu, p-vlera e ulët (< 0.001) mbështet hipotezën që teknologjia ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve.

A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja?



- Përgjigja "Po": 175 nga 224 nxënës (proporcioni 0.781)
- Përgjigja "Jo": 49 nga 224 nxënës (proporcioni 0.219)
- p-vlera: < 0.001
- Intervali i Besueshmërisë (95% CI) për "Po": [0.731, 1.000]

Po ashtu, shumica e nxënësve (78.1%) besojnë se përdorimi i teknologjisë ka pasur një ndikim pozitiv në cilësinë e njohurive të tyre. P-vlera më e vogël se 0.001 tregon mbështetje të fortë për H1.

Hipoteza Null : Integrimi i teknologjisë nuk ka ndikim në cilësinë dhe efektivitetin e mësimin (proporcioni i përgjigjeve "Po" është 0.5).

H1: Integrimi i teknologjisë përmirëson cilësinë dhe efektivitetin e mësimin (proporcioni i përgjigjeve "Po" është më i madh se 0.5).

Në përfundim, të gjitha pyetjet tregojnë mbështetje të konsiderueshme për hipotezën

H1, duke treguar se nxënësit besojnë se përdorimi i teknologjisë në mësim ka një ndikim pozitiv në cilësinë dhe efektivitetin e mësimin.

- **Ho:** Perspektiva e nxënësve në lidhje me përdorimin e teknologjisë nuk ka ndikim në forcimin e cilësisë së mësimit dhe nuk reflekton në ndërgjegjen etike.
- **Hipoteza ndihmëse:** Perspektiva e nxënësve në lidhje me përdorimin e teknologjisë forcon cilësinë në mësim si dhe reflekton në ndërgjegjen etike.

Binomial Test

Binomial Test

Variable	Level	Counts	Total	Proportion	p	95% CI for Proportion	
A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike?	JO	84	224	0.375	1.000	0.321	1.000
	PO	140	224	0.625	< .001	0.569	1.000
A mendoni se është e rëndësishme që teknologjia të përdoret në mënyrë etike në mësim?	PO	193	224	0.862	< .001	0.818	1.000
	JO	31	224	0.138	1.000	0.102	1.000

Note. For all tests, the alternative hypothesis specifies that the proportion is greater than 0.5.

Descriptives Plots

A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike?





Tabela 2. Të Dhënat e Hipotezës Ndihmëse

- Përgjigja "Po": 140 nga 224 nxënës (proporcioni 0.625)
- Përgjigja "Jo": 84 nga 224 nxënës (proporcioni 0.375)
- p-vlera: < 0.001
- Intervali i Besueshmërisë (95% CI) për "Po": [0.569, 1.000]

Interpretimi: Rezultatet tregojnë se 62.5% e nxënësve mendojnë se përdorimi i teknologjisë ka ndikuar në ndërgjegjen e tyre etike. P-vlera është shumë e vogël (< 0.001), që tregon se ka prova të mjaftueshme për ta refuzuar hipotezën null dhe mbështetur hipotezën alternative. Pra, nxënësit besojnë se teknologjia ka ndikim në ndërgjegjen etike.

A mendoni se është e rëndësishme që teknologjia të përdoret në mënyrë etike në mësim?



- Përgjigja "Po": 193 nga 224 nxënës (proporcioni 0.862)
- Përgjigja "Jo": 31 nga 224 nxënës (proporcioni 0.138)
- p-vlera: < 0.001
- Intervali i Besueshmërisë (95% CI) për "Po": [0.818, 1.000]

Interpretimi: 86.2% e nxënësve mendojnë se përdorimi i teknologjisë në mësim duhet të jetë etik. P-vlera shumë e vogël ($p < 0.001$) sugjeron se hipoteza null refuzohet, duke mbështetur hipotezën alternative se teknologjia duhet të përdoret në mënyrë etike.

Të dy rezultatet e testit binomial mbështesin hipotezën alternative (H_1), duke sugjeruar se nxënësit janë të bindur që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikim në ndërgjegjen e tyre etike dhe është e rëndësishme që ajo të përdoret në mënyrë etike si dhe refuzimin e hipotezës null në të dy rastet.

KAPITULLI V

8.PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

8.1 Përfundimi

Ky hulumtim ofron një pamje të qartë mbi perceptimet dhe shqetësimet e nxënësve lidhur me përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor, dhe është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e shpejtësisë së avancimeve teknologjike dhe digjitalizimit të shkollave. Duke anketuar 224 nxënës, hulumtimi zbulohet se ndonëse një numër i madh nxënësish e vlerësojnë pozitivisht teknologjinë, ka gjithashtu një grup të rëndësishëm që ndien shqetësime lidhur me implikimet e saj në mësim.

1. Mungesa e Praktikimit në Kabinetet e Informatikës

Një nga gjetjet më domethënëse të hulumtimit është mungesa e praktikimit të kompjuterëve në kabinetet e informatikës. Pavarësisht se teknologjia është një pjesë integrale e kurrikulave të sotme, shumë nxënës ndjejnë se nuk po përfitojnë nga mundësitë që ofrojnë këto kabinete. Kjo mungesë praktikimi mund të ketë disa pasoja:

- **Njohuri të Pamjaftueshme:** Nxënësit që nuk kanë mundësi të praktikojnë përdorimin e kompjuterëve mund të zhvillojnë njohuri të pamjaftueshme mbi teknologjinë dhe aplikacionet e saj. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një epokë ku njohuritë teknologjike janë thelbësore për suksesin në karrierë.
- **Frika nga Teknologjia:** Kur nxënësit nuk praktikojnë përdorimin e kompjuterëve, ata mund të zhvillojnë frikë ose ndjenjën e paaftësisë për të punuar me teknologjinë. Kjo ndjenjë mund të përkeqësohet nëse ata shohin mësuesit ose bashkëmoshatarët e tyre duke përdorur teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe të efektshme.
- **Vështirësi në Zhvillimin e Aftësive Praktike:** Aftësitë praktike, si programimi, përdorimi i softuerëve dhe menaxhimi i sistemeve të informacionit, janë të nevojshme për të përgatitur nxënësit për sfidat e shekullit të 21-të. Mungesa e praktikës mund të pengojë zhvillimin e këtyre aftësive.

- **Përgjegjësia e Institucioneve Edukative:** Kjo situatë gjithashtu reflekton një përgjegjësi të rëndësishme për shkollat dhe institucionet edukative. Ato duhet të sigurojnë që kabinete e informatike të jenë të pajisura mirë dhe të ofrojnë mundësi praktike për të gjithë nxënësit. Nëse shkollat nuk ofrojnë një ambient të përshtatshëm për praktikë, ato mund të krijojnë një hendek të thellë në arsimimin dhe aftësitë e nxënësve.

Perceptimet e Nxënësve për Teknologjinë

Një nga gjetjet më domethënëse është se, pavarësisht nga mbështetja për teknologjinë, rreth 80 nxënës janë shprehur shqetësuar për përdorimin e saj. Kjo tregon se ekziston një kontradiktë në mënyrën se si nxënësit e perceptojnë teknologjinë: ata e shohin atë si një mjet të dobishëm, por gjithashtu kanë frikë se ajo mund të ndikojë negativisht në përvojën e tyre të të mësuarit. Kjo mund të lidhet me një ndjenjë të papërshtatshmërisë ose frikës nga teknologjia, veçanërisht nëse ata nuk kanë pasur mundësinë të praktikojnë përdorimin e saj në mënyrë efektive.

Ndikimi i Etikës në Përdorimin e Teknologjisë

Etika e përdorimit të teknologjisë është një temë kyçe në këtë hulumtim. Përdorimi i teknologjisë në mësim kërkon një qasje të fortë etike për të siguruar që nxënësit të zhvillojnë një kuptim të qartë të përgjegjësisë të tyre. Kjo përfshin aspekte si privatësia, sigurimi i informacionit dhe etikën e ndarjes së materialeve. Për të arritur këtë, mësuesit dhe shkollat duhet të ofrojnë udhëzime dhe trajnime mbi përdorimin e teknologjisë në një mënyrë që është përputhëse me normat etike dhe praktikat më të mira.

Cilësia e Mësimi dhe Integrimi i Teknologjisë

Përdorimi i teknologjisë mund të ketë një ndikim pozitiv në cilësinë e mësimi, por ky ndikim varet shumë nga mënyra se si ajo integrohet në procesin mësimor. Nxënësit që kanë akses në teknologji dhe që janë të trajnuar për ta përdorur atë në mënyrë efektive kanë më shumë mundësi të zhvillojnë aftësi të rëndësishme, si krijimtaria, bashkëpunimi dhe zgjidhja e problemeve. Megjithatë, për të arritur këtë, duhet një përkushtim më i madh nga ana e institucioneve edukative për të siguruar që teknologjia të përdoret si një mjet mësimor, dhe jo si një zëvendësim për mësimin tradicional.

Në përfundim, hulumtimi tregon se, pavarësisht nga entuziazmi për teknologjinë, është e nevojshme të rishikohen qasjet dhe praktikat aktuale në përdorimin e saj në arsim. Vetëm përmes një integrimi të mirë të etikës dhe një trajnimi të përshtatshëm, mund të krijojmë një ambient mësimor që e përdor teknologjinë si një mjet për të përmirësuar përvojën e të nxënësve.

8.2 Rekomandime

Duke u bazuar në gjetjet e hulumtimit, është e qartë se integrimi efektiv i teknologjisë në arsim kërkon një qasje dhe një angazhim të fortë nga ana e institucioneve edukative. Më poshtë janë disa rekomandime të detajuara për përmirësimin e përdorimit të teknologjisë në shkolla, me fokus të veçantë në praktikën e kompjuterëve dhe etikën e përdorimit të teknologjisë.

Zhvillimi i Programit Praktik:

- **Krijimi i Mundësive për Praktikë:** Shkollat duhet të krijojnë mundësi të rregullta për nxënësit për të përdorur kompjuterët dhe teknologjinë në mënyrë praktike. Kjo mund të arrihet përmes aktiviteteve pas shkollës, klubeve të teknologjisë ose projekteve grupore që kërkojnë përdorimin e softuerëve dhe mjeteve teknologjike.
- **Integrimi në Kurrikulë:** Praktika e përdorimit të kompjuterëve duhet të integrohet në lëndët ekzistuese, duke e bërë atë pjesë të natyrshme të procesit mësimor. Mësuesit mund të planifikojnë aktivitete që kërkojnë përdorimin e teknologjisë për të zgjidhur probleme ose për të krijuar projekte.

Pajisja e Kabineteve të Informatikës:

- **Modernizimi i Pajisjeve:** Kabinetet e informatikës duhet të jenë të pajisura me kompjuterë dhe teknologji moderne që janë të nevojshme për të përgatitur nxënësit për sfidat e shekullit të 21-të. Kjo përfshin gjithashtu softuerë të avancuar dhe mjete për programim, dizajn grafik dhe menaxhim të informacionit.
- **Sigurimi i Aksesit të Barabartë:** Të gjithë nxënësit duhet të kenë akses të barabartë nëkabinete dhe teknologji, për të siguruar që asnjë grup nuk diskriminohet në përfitimin e mundësive edukative që ofron teknologjia.

Trajnimi i Mësuesve:

- **Programet e Trajnimit:** Është thelbësore që mësuesit të marrin trajnime të rregullta mbi përdorimin e teknologjisë në klasë. Këto trajnime duhet të përfshijnë metodat më të mira të integritit të teknologjisë në mësimdhënie dhe mënyrat për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësi praktike.
- **Promovimi i Inovacionit:** Mësuesit duhet të inkurajohen të eksperimentojnë me mjete dhe teknologji të reja, duke ndarë përvojat dhe mësimet e nxjerra me kolegët e tyre. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një kulture të vazhdueshme të përmirësimit dhe inovacionit.

Inkurajimi i Bashkëpunimit dhe Mësimi Ndërmjet Nxënësve:

- **Aktivitete Grupore:** Nxënësit duhet të inkurajohen të punojnë së bashku në projekte teknologjike, duke ndihmuar njëri-tjetrin dhe duke ndarë njohuritë e tyre. Kjo do të forcojë aftësitë e tyre të punës në grup dhe do t'i ndihmojë ata të zhvillojnë një kuptim më të thellë të teknologjisë.
- **Projekte Ndërdisciplinore:** Krijimi i projekteve ndërdisciplinore që kombinojnë teknologjinë me lëndë të tjera, si shkenca, arti ose historia, do të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se si teknologjia mund të aplikohet në kontekste të ndryshme dhe të zgjerojë horizontet e tyre.

Promovimi i Etikës në Përdorimin e Teknologjisë:

- **Edukimi mbi Etikën:** Nxënësit duhet të marrin edukatë mbi etikën e përdorimit të teknologjisë, duke përfshirë rregullat e privatësisë, përgjegjësitë ndaj informacionit dhe ndarjen e materialeve. Kjo mund të arrihet përmes seminareve, workshop-eve dhe diskutimeve në klasë.

- **Krijimi i Politika të Qarta:** Shkollat duhet të zhvillojnë politika të qarta mbi përdorimin e teknologjisë dhe të sigurojnë që nxënësit t'i njohin ato. Këto politika duhet të përfshijnë udhëzime mbi sjelljen e duhur në internet dhe përdorimin e resurseve teknologjike në mënyrë të përgjegjshme.

Vlerësimi i Progresit dhe Rishikimi i Praktikave

- **Monitorimi dhe Vlerësimi:** Është e rëndësishme që shkollat të monitorojnë dhe vlerësojnë rregullisht përdorimin e teknologjisë dhe efektivitetin e praktikave të mësimdhënies. Kjo mund të arrihet përmes anketave të rregullta me nxënësit dhe mësuesit, si dhe analizave të rezultateve akademike.
- **Rishikimi i Strategjive:** Bazuar në rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit, shkollat duhet të jenë të gatshme të rishikojnë dhe përmirësojnë strategjitë e tyre për integrimin e Teknologjisë sepse përdorimi i teknologjisë mund të përmirësojë mësimdhënien si dhe të përgatis nxënësit në një mjedis ku teknologjia ka një rol kyç. Kjo do të ndihmojë në adaptimin e praktikave edukative për të përmbushur nevojat e nxënësve në një botë në ndryshim.

Përmes këtyre rekomandimeve, shkollat mund të krijojnë një ambient më të përshtatshëm dhe më të mbështetur për përdorimin e teknologjisë në arsim. Duke investuar në praktika të mira, trajnim të mësuesve dhe edukimin e nxënësve mbi etikën dhe përgjegjësitë e përdorimit të teknologjisë, mund të sigurojmë që nxënësit të jenë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë që nevojiten për të përballuar sfidat e së ardhmes. Kjo do të kontribuojë në zhvillimin e individëve të përgjegjshëm dhe të aftë që do të ndihmojnë në krijimin e një shoqërie më të avancuar dhe më të qëndrueshme.

Literatura

- AKCESK. (2020). *Udhëzime për Mbrojtjen Online të Fëmijëve*. <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Policy-makers-converted.pdf> (faqe,11).
- Aragon, D. G. (2010). *Blended Learning: A Disruptive Innovation*. Journal of Asynchronous Learning Networks (E marrë më 15 Korrik ora 13:00, Faqe-10).
- aty), M. W. (2017). *Etika në Sistemin Arsimor Shqiptar*. Gjetur në <https://epale.ec.europa.eu/sites/default/files/raport-studimin-etika-ne-sistemin-arsimor-ne-shqiperi.pdf> (E marrë në ora 14:00 më 20 Prill 2024)
- Baker, R. J. (2019). *Educational Data Mining and Learning Analysis: Issues and Opportunities*. Shtetet e Bashkuara: Revista: Educational Data Mining Conference Proceedings (E marrë më 02 Gushtë ora 18:20 , Faqe 88-102).
- Bates, T. (2015). *Guidelines for Designing Teaching and Learning*. Teaching in a Digital Age (E marrë më 15 Korrik ora 10:00).
- Berisha, G. (2018). *TEKNOLOGJIA E INFORMIMIT DHE E KOMUNIKIMIT*. Pejë. Gjetur në https://detyratshkollore-tik.weebly.com/uploads/7/0/5/0/7050218/tik_12-ligjeratat_gjy_i_-_r%C3%AB_-_pjesa_e_par%C3%AB.pdf (E marrë më datë 2 Korrik 2024 në ora 02:00)
- Bowers, A. S. (2011). *Privacy, Security and Ethics of Educational Data: A Survey*. Shtetet e Bashkuara: Revista Journal of Educational Technology (E marrë më 01 Gushtë ora 14:20 , Faqe 115-130).
- Brodowicz, M. (2024). *The Impact of Technology on Students' Academic Performance and Engagement*. Gjetur në <https://aithor.com/essay-examples/the-impact-of-technology-on-students-academic-performance-and-engagement>(E marrë më datë 3 Korrik 2024 në ora 13:00)
- Clark, R. E. (1994). *Educational Technology: A Review of the Research*. Google Scholar (E marrë më 15 Korrik ora 12:00, Faqe 21-22).
- Council, N. R. (2000). *The Digital Dilemma: Intellectual Property in the Information Age*. National Academy Press (E marrë më 16 Korrik ora 11:25, Faqe 64-66) .
- Davidson, C. N. (2022). *"The Role of Technology in Enhancing Learning Experiences"*. Shtetet e

- Bashkuara: Revista: Teaching and Teacher Education(E marrë më 08 Gushtë ora 14:05 , Faqe 103-120).
- Dawson, S. (2013). *Evaluating Technology-Enhanced Learning*. Shtetet e Bashkuara: IGI Global (E marrë më datë 2 Korrik 2024 në ora 01:10).
- DEMELEZI, K. (2017). *Implementimi i Tik në Shkolla Filllore dhe të Mesme*. Gjetur në <https://gjejeveten.files.wordpress.com/2019/01/implementimi-i-tik-ne-shkolla.docx> (E marrë në ora 13:00 më 20 Prill 2024)
- Duranti, L. (2008). *Technology and Ethics: A European Perspective*. Link në Routledge (E marrë më 01 Gushtë ora 13:10 , Faqe 122-124) .
- Ejupi, B. (2021). *E ARDHMJ E ARDHMJ A E EDUKIMI A E EDUKIMIT DHE TEKNOLOGJITË DIGJITALE*. Prishtinë: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/cgi/viewcontent.cgi?article=2905&context=etd> (E marrë në ora 9:10 më 2 Prill 2024).
- Floridi, L. (2010). *The Cambridge Handbook of Information and Computer Ethics*. Link në Google Books (E marrë më 15 Korrik ora 22:25, Faqe 50-55).
- Floridi, L. (2013). *The Ethics of Information*. Oxford University Press (E marrë më datë 29 në ora 21:05 Faqe,98,175).
- Green, P. M. (2022). *Ethics in Teaching and Learning: Principles and Practices*. Journal of Educational Ethics (Faqe, 102-104).
- Green, S. (2022). *Ethical and Privacy Issues in the Use of Technology*. Ethics in Technology, vol. 12, no. 5 (Faqe, 23-40).
- HAJDARI, B. (2019). *INTERNETI DHE TEKNOLOGJIA NË MËSIMDHËNIE*. doi:DOI: <https://doi.org/10.53555/nnbma.v5i12.816>
- HAJDARI, P. A. (2019). *Interneti dhe Teknologjia në Mësimdhënie*. (I. 2456-3544, Re.) Gjetur në NN Publication <https://nnpub.org/index.php/BMA/article/view/816>(E marrë në ora 10:00 më 20 Prill 2024)
- Hall, D. E. (2021). *"Ethics and Technology in Education"*. Journal of Educational Technology & Society

(faqe ,87).

Harrison, K. P. (2022). *"The Role of Privacy Laws in Modern Educational Systems"*. Australi: Revista: Journal of Educational Law and Policy(E marrë më 03 Gushtë ora 01:55 , Faqe 76-89).

Hattie, J. (2019). *"The Benefits of Technology Integration in Education: A Comprehensive Review"*.

Shtetet e bashkuara: Revista: Review of Educational Research(E marrë më 05 Gushtë ora 13:27 , Faqe 117-145).

Haxhijaj, E. (2023). *Ndikimi i teknologjisë arsimore në shkolla*. <https://albanianeducation.net/nga-egzon-haxhijaj-ndikimi-i-teknologjise-arsimore-ne-shkolla> (E marrë më 05 Korrik ora 22:00).

HELD, V. (2006). *The ethics of care: Personal, political, and global*. New York, 9780195180992: Oxford University Press ((E marrë në ora 8:00 më 20 Prill 2024).

Jasanoff, S. (2016). *The Ethics of Invention: Technology and the Human Future*. Link në Google Books (E marrë më 15 Korrik ora 16:55, Faqe 12-15).

Johnson, T. A. (2021). *"Ethical Practices in Educational Data Collection"*. Shtetet e Bashkuara: Revista: Ethics in Education Journal (E marrë më 03 Gushtë ora 00:20 , Faqe 37-52).

Jones, L. (2021). *Challenges in Protecting Digital Privacy*. International Journal of Information Security (faqe,78-92).

Kieffer, P. E. (2019). *Ethics in Technology: A Comprehensive Introduction*. Link në Google Books (E marrë më 15 Korrik ora 19:55, Faqe 20-22) .

Luckin, R. M. (2020). *"Technology-Enhanced Learning: Opportunities and Challenges"*. Mbreteri e Bashkuar: Revista: Educational Technology Research and Development (E marrë më 05 Gushtë ora 19:21 , Faqe 345-367).

MacLeod, D. J. (2021). *"Advancements in Technology and Their Impact on Education"*. Kanada: Revista: Journal of Technology in Education (E marrë më 08 Gushtë ora 21:07 , Faqe 298-213).

Martinez, L. R. (2023). *"Managing Data Privacy in the Digital Age: Strategies for Educators"*. Kanada: Revista: Tech in Education Review (E marrë më 02 Gushtë ora 23:10).

Mayer, R. E. (2021). *"Educational Technology and the Impact on Learning Outcomes"*. Shtetet e

- Bashkuara: Revista: Journal of Educational Psychology(E marrë më 05 Gushtë ora 17:21 , Faqe 215-235).
- Mayer, Richard E. (2020). *Multimedia Learning*. doi:Cambridge University Press, 2009 (E marrë më datë 21 Gusht[ora 16:19)
- McGreal, R. (2017). *Ethics of Educational Technology*. ResearchGate.
- Mexhuani, A. (2014). *INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës (E marrë më datë 3 Korrik 2024 në ora 14:00). Gjetur në <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/Integrimi-i-TIK-ut-ne-mesimdhenie-dhe-nxenie.pdf> (Faqe,7)
- Moore, M. G. (2013). *Handbook of Distance Education*. Handbook of Distance Educatio (E marrë më 15 Korrik ora 14:45, Faqe 122-145).
- Murphy, A. L. (2021). *Protecting Student Data: Strategies and Best Practices*. Shtetet e Bashkuara: Revista: Journal of Educational Technology (E marrë më 05 Gushtë ora 11:55 , Faqe 304-319).
- MWL. (2017). *Etika në Sistemin Arsimor Shqiptar*. Tiranë, ISBN 978-9928-07-491-1, Faqe,19: Shtëpia Botuese “Mirgeeralb”. Gjetur në <https://epale.ec.europa.eu/sites/default/files/raport-studimin-etika-ne-sistemin-arsimor-ne-shqiperi.pdf>
- Nelson, M. T. (2022). *Student Data Privacy: An Overview of Legal and Policy Issues"*. Shtetet e Bashkuara: Revista: Educational Policy Analysis Archives (E marrë më 03 Gushtë ora 03:55 , Faqe 221-237).
- O'Neil, A. E. (2020). *"Privacy and Security in Education: Understanding the Challenges"*. Shtetet e Bashkuara: Revista: Educational Technology Research and Development (E marrë më 02 Gushtë ora 20:20 , Faqe 123:129).
- Prensky, M. (2001). *Digital Natives, Digital Immigrants*. Digital Learning (Faqe, 5).
- Quinn, M. J. (2011). *Ethics in Technology: A Practical Guide*. Wiley (E marrë më 16 Korrik ora 14:25, Faqe 45-47) .

- Rheingold, H. (2012). *Net Smart: How to Thrive Online*. Google Books (Faqe, 152).
- Robinson, K. (2015). *Creative Schools: The Grassroots Revolution That's Transforming Education*. Viking (E marrë më 05 Korrik ora 23:18). Gjetur në https://books.google.com/books/about/Creative_Schools.html?id=4EKLDQAAQBAJ
- Sanden, R. E. (2006). *Information Technology Ethics: Cultural Perspectives*. Link në IGI Global (E marrë më 01 Gushtë ora 10:10 , Faqe 45-47).
- Selwyn, N. (2019). *Data Privacy in Education: A New Ethical Landscape*. ERIC.
- Shehu, M. (2020). *Roli i teknologjisë në mësimdhënien dhe mësimin e gjuhës së huaj*. <https://diasporashqiptare.al/2020/04/03/roli-i-teknologjise-ne-mesimdhenien-dhe-mesimin-e-gjuhes-se-huaj/> (E marrë më 1 Shkurt ora 22:32).
- Sivasubramanian, M. (2021). *Artificial Intelligence in Our Daily Lives*.
- Smith, J. (2022). *Data Protection and Privacy in Educational Systems: Emerging Issues*. Mbreteria e Bashkuar: Revista: International Journal of Educational Policy (E marrë më 01 Gushtë ora 18:20 , Faqe 45-46).
- Spinello, R. (2003). *Cyberethics: Morality and Law in Cyberspace*. Link në Jones & Bartlett Learning (E marrë më 16 Korrik ora 18:10, Faqe 89-91) (faqe 89-91).
- Squire, K. D. (2011). *Video Games and Learning: Teaching and Participatory Culture in the Digital Age*. Shtetet e Bashkuara: Teachers College Press (E marrë më datë 1 Korrik 2024 në ora 23:00).
- Tavani, H. T. (2011). *Ethics of Technology: A Philosophical Study*. Link në Google Books (E marrë më 15 Korrik ora 16:00, Faqe 3-5) .
- Thomas, J. W. (2003). *The Impact of Technology on Education*. Google Scholar (E marrë më 15 Korrik ora 14:00, Faqe 78-89).
- Turkle, S. (2015). *Reclaiming Conversation: The Power of Talk in a Digital Age*. Google Books (Faqe, 112).
- Vallor, S. (2016). *Technology and the Virtues: A Philosophical Guide to a Future Worth Wanting*. Oxford University Press (E marrë më datë 29 në ora 18:00 Faqe,45).

- Watson, E. C. (2024). *Ethical Guidelines for Technology in Education*. Educational Technology Research and Development (Faqe,95).
- White, T. R. (2023). *Ethical Practices in Education: A Comprehensive Review*. Educational Research Quarterly (Faqe, 78-80).
- Williams, L. (2023). *Ethical Aspects and Challenges in Preserving Privacy in Modern Technologies*. Journal of Ethics and Technology, vol. 16, no. 4 (Faqe,128).
- Zatriqi, L. (2022). *Efekti i punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lënden e Teknologjisë*. Prishtinë: <https://edukimi.uni-pr.edu/desk/inc/media/0323340E-AA71-4935-9CF3-24BDDFC7953F.pdf>.

SHTOJCAT



Pytësor

Ky pytësor është një formular i cili do të përdoret për rast studimi. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të marrim sa më shumë informacione lidhur me temën Etika e Përdorimit të Teknologjisë dhe efekti në mësimnxënje. Të dhënat në këtë pytësor do të jenë anonime. Ju faliminderit për kohën tuaj!

1. Gjinia

- ☐ M
- ☐ F

2. Moshë

- ☐ 9-10
- ☐ 10-12
- ☐ 12-14
- ☐ 15

3. Emri Shkollës

- ☐ Thimi Mitko
- ☐ Selami Hallaçi
- ☐ Musa Zajmi

4. A mendoni se përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në cilësinë e njohurive tuaja ?

- ☐ Nuk pajtohem fare
- ☐ Nuk pajtohem
- ☐ Pajtohem
- ☐ Pajtohem plotësisht

5. A mendoni që përdorimi i teknologjisë ka ndryshuar mënyrën si mësoni, veçanërisht në krahasim me mënyrën tradicionale të mësimi?

- ☐ Nuk pajtohem fare
- ☐ Nuk pajtohem
- ☐ Pajtohem
- ☐ Pajtohem plotësisht

6. A keni vërejtur ndonjë ndryshim në motivimin tuaj për të mësuar kur teknologjia përdoret në mësim?

- ☐ Jo
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Po

7. A mendoni se teknologjia mund të ndihmojë për të përmirësuar cilësinë e mësimit dhe për të arritur qëllimet e arsimit?

- ☐ Nuk pajtohem fare
- ☐ Nuk pajtohem
- ☐ Pajtohem
- ☐ Pajtohem plotësisht

8. Çfarë përparësish mendoni se vijnë nga përdorimi i teknologjisë në mësim në krahasim me metodat tradicionale?

9. A mendoni që përdorimi i teknologjisë në mësim ka ndikuar në ndërgjegjen tuaj etike, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe sigurinë në internet?

- ☐ Nuk pajtohem fare
- ☐ Nuk pajtohem
- ☐ Pajtohem
- ☐ Pajtohem plotësisht

10. A keni ndonjë shqetësim për çështjet etike në lidhje me përdorimin e teknologjisë në mësim? Nëse po, cilat janë ato dhe si mendoni se mund të adresohen?

11. A mendoni se është e rëndësishme që teknologjia të përdoret në mënyrë etike në mësim?

- ☐ Nuk pajtohem fare
- ☐ Nuk pajtohem
- ☐ Pajtohem
- ☐ Pajtohem plotësisht

12. Qfare do te deshironit te ndryshonte ne perdorimin e teknologjise ne shkollen tuaj?
